

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7758 E enjte 10 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion Ditës

Nga JORGJI KOTE

Kandidaturë e spikatur për kreun e KiE-së



Sapo është konfirmuar se ministri i Jashtëm 61-vjeçar Didier Reynders ka paraqitur me mbështetjen e qeverisë belge kandidaturën si Sekretar i ri i Përgjithshëm ...
Vijon në faqen 20

Opinion Ditës

Nga ANXHELA PEZA

Problemet në çift çojnë deri në vrasjen e gruas



Viti 2019 ka nisur me ekzekutimin e gruas. Një grua shqiptare vritet nga babai, vëllai, bashkëshorti, kunati, vjehëri çdokush ka të "drejtën" për ta vrasur atë...
Vijon në faqen 21



Elona Meçani - Unë do të sugjeroja kështu, jepi një 500 euro!
Gjyqtari i thotë denoncueses ta prekë në organin gjental dhe ta shtrëngojë fort



Roland Hysit - Fort... eëë aty...

Përgjimi i Roland Hysit: Unë të q... më beso

"Do bësh qejf me mua, jam mashkull potent", arrestohet gjyqtari dhe psikologjia seksere

Skandali i gjyqtarit të Fierit, i kërkon seks gruas së divorcuar: Mua më vijnë nga pas

TIRANË-Gjyqtari Roland Hysit, i cili i kërkonte rryshfët dhe marrëdhënie seksuale një nëne të divorcuar në këmbim të dhënies së kujdestarisë së fëmijës së saj është arrestuar dhe nga policia e Tiranës në bashkëpunim me atë të Fierit. Gjithashtu, në pranga ka përfunduar dhe sekserja, Elona Meçani, e cila është psikologe pranë Gjykatës ...
Në faqen 6

MIRATOHEN LEVIZJET NE QEVERI, PRESIDENTI NUK SHKARKON DITMIR BUSHATIN

META DEKRETON 4 MINISTRA, MBETET "PEZULL" GENT CAKAJ

Rama në zyrën e kreut të shtetit, mungon dekreti për ministrin e Jashtëm. Përplasja për KLSH, ikën Leskaj. Meta: Veprim antiligjor, rrezikohet institucioni



(Në foto) Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

PROTESTA

Studentët në bojkot: S'hyjmë në mësim, të rrezohet ligji i arsimit

Në faqen 2

PERGJIGJJA

Edi Rama: Edhe ata me nota 4 dhe 5 do të paguajnë 50% të tarifave

Në faqen 3

MOTI I FTOHTE

Vendi pushtohet nga bora e acari, pezullohet mësimi në 280 shkolla

Në faqen 10

KOSOVE-SERBI

Shkëmbimi i territoreve, çfarë mendojnë analistët e huaj

Në faqen 16

TABELA



Procedurat e reja në Hipotekë, afatet e tarifave për çdo shërbim

Në faqen 8

"Zëri i Amerikës": Firma fantazmë aplikoi për Unazën e Re pa u regjistruar në QKR

Skandali, institucionet favorizuan "DH Albania"

"Komisioni i Licencave i shërben firmës që fitoi 30 mln euro me falsifikim: Zbatuam ligjin"

NGA ARMAND MERO

Në Shqipëri zbulohen detaje të tjera lidhur me kompaninë 'DH Albania', e cila fitoi garën për ndërtimin e një pjesë të Unazës së Re në Tiranë, duke përdorur dokumente të falsifikuar të një kompanie amerikane "Dunwel



Haberman". 'Zëri i Amerikës' ka siguruar informacione që dëshmojnë se administrata shqiptare ka ndihmuar kompaninë 'DH Albania' për marrjen e licencës së ndërtimit në zbatim, duke nisur procedurat, përpara se vetë kompania të regjistrohej zyrtarisht ...
Në faqen 11

PROTESTA E STUDENTËVE REAGIMET

Çibukaj: Pedagogët janë solidarizuar me ne. Ministria bën deklarata para kapitullimit

Studentët bojkotojnë mësimin, konfrontohen me policët e dekanët

"Qëndresa jonë do të vazhdojë deri në rrëzimin e ligjit"

Voltiza Duro

Studentët e disa prej universiteteve publike në vend kanë bojkotuar ditën e djeshme mësimin në shenjë proteste deri në plotësimin e kërkesave të tyre. Auditorët ngelën bosh, në një kohë që studentët diskutonin mbi hapat e mëtejshëm që do të ndërmarri. Edhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës është bojkotuar masivisht mësimi. Studentët tregojnë se pavarësisht presioneve të shumta dhe sjelljes arrogante të rektorit të këtij universiteti, ata refuzojnë të kthehen në audiorë pa u plotësuar kërkesat e tyre dhe pa u anuluar ligji i arsimit të lartë. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', Arbjo Çibuka, studente në Fakultetin e Histori-Filologjisë tregon se pavarësisht presioneve të shumta dhe sjelljes arrogante të rektorit të këtij universiteti, ata refuzojnë të kthehen në audiorë pa u plotësuar kërkesat e tyre dhe pa u anuluar ligji i arsimit të lartë. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', Arbjo Çibuka, studente në Fakultetin e Histori-Filologjisë tregon se shumica ka vendosur të vazhdojë protestën brenda në fakultete në një kohë që edhe vetë pedagogët janë solidarizuar me të rinjtë. Studentja shton se nuk do të tërhiqen deri në rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë.

Sot (dje) studentët sërish kanë bojkotuar mësimin. Kjo do të jetë forma e protestës tashmë nga ana juaj?

Ditën e djeshme në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë kemi zhvilluar dy mbledhje për të diskutuar se si do të vijojë protesta. Me vendimin e shumicës vendosëm që forma do të ishte bojkoti brenda në fakultet. Tani do të vazhdojmë në këtë mënyrë protestën, duke e mbajtur me aktivitetet të ndryshme si psh: ligjërime, muzikë, të shohim filma etj.

A kemi pasur konfrontime me policinë?

Në fakultetin ku unë studioj nuk kemi pasur konfrontime me policinë. Policia ka ardhur, por ka qëndruar jashtë pasi studentët kanë filluar të bëjnë thirrje kundër tyre. Në fakultete të tjera



Arbjo Çibuka, studente në Fakultetin e Histori-Filologjisë

AKUZAT

"Kur MASR përfundon duke publikuar edhe teknikalitetet të tilla, kjo tregon për gjithë joseriozitetin dhe përpjekjen e pushtetit për të manipuluar situatën në dukje pa asnjë lloj garancie për zgjidhjen e problemit dhe panikun në të cilin ndodhen ata, përpëllitjet për ta shitur si punë edhe çdo teknikalitet burokratik janë aktet e fundit të dëshpërimit para kapitullimit".



Studentët pas bojkotimit të mësimit

PLAS TRANSFORMATORI NË UBT

Ka shpërthyer transformatori elektrik në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Ky transformator, i cili sipas rregullit duhet të qëndronte jashtë ambienteve, është futur brenda për shkak të mungesës së energjisë elektrike në këtë universitet.

KËRKESAT E STUDENTËVE

- Përgjysmimin e tarifave në TË GJITHA nivelet e studimit (sidomos në master);
- Rritjen në 50% të peshës së VOTËS STUDENTORE;
- Dyfishimin e BUXHETIT TË SHTETIT për universitetet publike;
- Ndalimin e financimit publik të UNIVERSITETEVE PRIVATE.
- Të zbatohen ligjet për individët: "Për statusin e të verbrit", "Për statusin e jetimit", "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" etj. Të cilët duhet të kenë lehtësira për pagesën e tarifës vjetore.
- Të pyeten dhe të konsultohet me studentët të cilët kanë këtë status për çdo moszbatim të ligjit dhe ndryshime të tij.
- Të merren në konsideratë çdo sugjerim i studentëve me statusin, "Për statusin e të verbrit", "Për statusin e jetimit", "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" etj.
- *Asnjë kërkesë nuk mund të realizohet pa rrëzimin e ligjit të arsimit të lartë.

kanë hyrë brenda ambienteve të fakultetit, por sërish janë përcjellë jashtë nga studentët. Sipas Ligjit të arsimit të lartë, neni 5, pika dh, ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike bëhet me kërkesë ose lejen e titullarit të institucionit të arsimit të lartë. Është më se e qartë se kjo bëhet për presion ndaj studentëve, por ne kemi arritur të tregojmë se nuk ia kemi frikën asnjë autoriteti.

Po pedagogët apo stafi akademik a ka ushtruar presion ndaj studentëve në mënyrë që këta të fundit t'i kthehen mësimin?

Për sa i përket fakultetit tim pedagogët janë të solidarizuar me ne dhe nuk na kanë ushtruar presion në asnjë moment. Me sa informacion kam për fakultetet e tjera ka pasur pedagogë, të cilët kanë ushtruar presion ndaj studentëve. Po ashtu edhe dekanët kanë debatuar me studentët p.sh.

Ministria u kërkon IAL-ve numrin e studentëve që marrin bursë

Në një kohë që studentët kanë bojkotuar mësimin, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka

lartë informacion lidhur me numrin total të studentëve që përfitojnë në rast të plotësimit të kriterëve për të vijuar me financimin. "Tërheqim vëmendjen e sekretarive mësimore pranë universiteteve që të bëjnë njoftimin e nevojshëm për studentët dhe të garantojnë informacionin sipas vendimeve të sipërcituara. Veprimtaria e tyre do të monitorohet dhe do të mbahet qëndrim, bazuar në ligj, për këdo që keqinformon apo vepron në kundërshtim me vendimet e marra nga Këshilli i Ministrave", -thuhet në njoftimin e djeshëm nga Ministria e Arsimit.



tek Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minerave. Rektori i Universitetit Bujqësor, gjithashtu, është përplasur me studentët. Por studentët janë të vendosur të rezistojnë deri në plotësimin e kërkesave dhe rrëzimin e ligjit të arsimit të lartë.

Cilat janë kërkesat tuaja tashmë dhe si do të veprojnë nëse nuk realizohen?

Tani për tani këto janë kërkesat më imediatë: përgjysmimin e tarifave në

TË GJITHA nivelet e studimit (sidomos në master); rritjen në 50% të peshës së VOTËS STUDENTORE; dyfishimin e BUXHETIT TË SHTETIT për universitetet publike; ndalimin e financimit publik të UNIVERSITETEVE PRIVATE. Asnjë kërkesë nuk mund të realizohet pa rrëzimin e Ligjit të Arsimit të Lartë.

Si e vlerësoni deklaratën e MASR nëpërmjet së cillës ka kërkuar numrin e studentëve që plotësojnë kri-

PEDAGOGËT E EKONOMIKUT KRAH STUDENTËVE

Pasditën e djeshme, studentët e Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës kanë bërë një diskutim me pedagogët ku kanë vendosur zyrtarisht me njëri-tjetrin për vazhdimin e protestës. Kryetari i Studentëve në Senatën Akademik të UT, Kristian Kina tregon se studentët janë dakordësuar me stafin akademik. "Pedagogët na premuan që nuk do marrin mungesa dhe nuk do të zhvillojnë mësim pa gjysmën e numrit total të klasës", - thekson Kina për 'GSH'.

teret për të përfituar bursat?

Kur MASR përfundon duke publikuar edhe teknikalitetet të tilla kjo tregon për gjithë joseriozitetin dhe përpjekjen e pushtetit për të manipuluar situatën në dukje pa asnjë lloj garancie për zgjidhjen e problemit dhe panikun në të cilin ndodhen ata, përpëllitjet për ta shitur si punë edhe çdo teknikalitet burokratik janë aktet e fundit të dëshpërimit para kapitullimit.



Brenda janarit do të publikohet edhe dokumenti i Paktit për Universitetin

Studentët, Rama: Edhe ata me 4 dhe 5 do paguajnë 50 % të tarifës

"Ka rektorë që bëjnë lojën e nënëdajës"

Kryeministri Edi Rama ka garantuar edhe një herë studentët se brenda muajit janar Pakti për Universitetet do të vijë më i plotë, duke garantuar zgjidhjen e të gjitha kërkesave të studentëve sipas afateve të përcaktuara. Duke shfrytëzuar dje bashkëqeverisimin e përjavshëm të bashkëqeverisjes me qytetarë, kreu i qeverisë nisur edhe nga pretendimet e studentëve se asnjë nga masat e marra nga qeveria nuk ka nisur të japë efektet e veta, ka theksuar se kërkesat e studentëve do të plotësohen të gjitha dhe se shumë shpejt do të bëhet i ditur dokumenti i plotë i Paktit për Universitetin. "Në harkun e muajit, një dokument jo përfundimtar, por për diskutim të brendshëm brenda universitetit. E pata thënë në fillim që protesta do të shuhej, por ne dhe unë personalisht nuk do ta lëmë frymën e protestës të tretet, bashkë me protestuesit, por do t'i shkojmë deri në fund, duke shfrytëzuar këtë potencial të madh transformues për universitetin", - tha kryeministri. Më tej ai shtoi se të gjitha vendimet e miratuara në fund të dhjetorit nga qeveria janë publikuar në Fletoren Zyrtare dhe se tashmë kanë nisur të japin efektet konkrete. "Më ka bërë përshtypje që dikush ua ka mësuar, apo dikush i ka keqinformuar: Pse nuk janë në Fletoren Zyrtare? Kur do dalin në Fletoren Zyrtare? Pse jemi akoma të llaft, memet, instastories, e duam në Fletoren Zyrtare. Vendimet e qeverisë kanë dalë në Fletoren Zyrtare, mjafton një klik në qbz.gov.al, është Fletorja Zyrtare online. Janë të tëra të publikuara, por nuk duhet përtuar të lexosh dhe nuk duhet kaq gatishmëri e madhe që çdo broçull ta marrësh dhe ta kthesh në arsye për të qenë i revoltuar", - shtoi Rama. Ai edhe një herë ka sqaruar se asnjë student nuk do paguajë më shumë se 50 për qind të tarifës së studimit, ndërsa kategori të caktuara nuk do të paguajnë asnjë lek. Ai bëri të ditur gjithashtu, se vendimet i janë transmetuar të gjithë rektorëve dhe dekanëve. "Qeveria do të paguajë 50% të tarifës së studimit për studentët pa përjashtim, përfshirë edhe ata me katra dhe me pesa për këtë vit akademik, duke iu dhënë mundësinë të përmirësohen vitin e ardhshëm. Do të paguajë 100% tarifën e studimit për ata me 9-10 mesataren, për ata nga familje me



Kryeministri Edi Rama gjatë takimit të djeshëm me qytetarët

PEDAGOGËT
"Ka pedagogë që nuk duan të bëjnë mësim, që refuzojnë të vazhdojnë mësimin, qoftë edhe me një student që do të bëjë mësim, ndërkohë që, në fakt, nuk është një, por është shumicë që kanë dashur të bëjnë mësim, por preferojnë që t'i lënë studentët rrugëve, sepse duan të rrinë vetë nëpër kafe"

Indeksi i 'The Economist': Demokracia në Shqipëri, një guaskë boshe

Shqipëria u rendit në vendin e 76 në botë në Indeksin e Demokracisë të publikuar nga 'The Economist'. Në raport me një vit më parë, Shqipëria ka të njëjtin pikëzim, në 5.98, ndërsa është përmirësuar me një vend. Treguesi ku vendi ynë merr më pak pikë është ai i funksionimit të qeverisë me 4.71 pikë, duke u renditur me vende të tilla si Ukraina, Bosnja, Gjeorgjia, Bjellorusia, Rusia, të cilat marrin pak pikë në indeksin e funksionimit të qeverisë. Ndërsa më mirë dinë të qeverisin vendet e tjera të rajonit, si Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi me nga 5.36 pikë secila. Një pikëzim i ulët i këtij treguesi nënkupton që "nëse vendimet e marra në mënyrë demokratike nuk mund ose nuk zbatohen atëherë koncepti i demokracisë nuk është shumë kuptim-



plotë, por është një guaskë boshe". Më mirë, Shqipëria renditet në treguesin e "lirive civile", me 7.65 pikë, e ndjekur nga "procesi elektoral dhe pluralizmi" me 7 pikë, "pjesëmarrja politike" me 5.56 pikë dhe "kultura politike" me 5 pikë, bënë të ditur Monitor. Në Europën Lindore, Shqipëria renditet e 13-a dhe bën pjesë në regjimin e demokracive hibride, ku përfshihen 39 sh-

tete. Demokracia hibride është kategoria e tretë e renditjes së renditjes së 'The Economist', pas demokracisë së plotë, demokracisë me probleme, ndërsa kategoria e katërt është regjimi autoritar. Vendi më demokratik në botë është Norvegjia, i ndjekur nga Islanda, Suedia, Danimarka, Irlanda, Finlanda, Zvicra, Holanda, Luksemburgu dhe dhjetësa e vendeve me demokracië në botë mbyllet nga Gjermania. Indeksi i demokracisë së Njësisë së Inteligjencës të 'The Economist' bazohet në pesë kategori: procesi zgjedhor dhe pluralizmi i qeverisë; pjesëmarrja politike; dhe kulturën politike; ku më të rëndësishme janë kushtet për të pasur zgjedhje të lira dhe të ndershme konkurruese dhe aspektet të kënaqshme të lirisë politike.

ndihmë ekonomike, për ata me aftësi të kufizuara dhe kategori të specifikuar, të cilat do të marrin edhe një bursë studimi prej 10 mijë lekësh të reja në muaj. Këtë që edhe bufat e Parkut të Liqenit Artificial e kanë marrë vesh, nuk e paskan marrë vesh disa sekretari universitetesh", - theksoi Rama. Kryeministri nuk ka lënë pa sulmuar edhe pedagogët, si dhe drejtuesit e universitetit, të cilët sipas tij po bëjnë lojën e opozitës. "Ka pedagogë që nuk duan të bëjnë mësim, që refuzojnë të vazhdojnë mësimin, qoftë edhe me një stu-

dent që do të bëjë mësim, ndërkohë që, në fakt, nuk është një, por është shumicë që kanë dashur të bëjnë mësim, por preferojnë që t'i lënë studentët rrugëve, sepse duan të rrinë vetë nëpër kafe. Siç ka drejtues universitetesh, që,

për arsye të frikës se ky proces hap pas hapi do të shkojë drejt tyre, sepse kanë edhe ata llogaritë e tyre për të dhënë, që nga rektorit i UT-së, bëjnë lojën e "nënëdajës". Por kjo është temë tjetër", - tha Rama.

Gjyknuri dhe Balluku, bashkë në dialog me profesorët

Pas dialogut të hapur që zhvilloi vetë kryeministri, Edi Rama gjatë muajit dhjetor me studentët dhe pedagogët, tashmë ai ka urdhëruar gjithë ministrat e kabinetit të tij qeveritar që të përfshihen në një debat të brendshëm me gjithë universitetet për të diskutuar zgjidhjet e ofruara, por edhe përmirësimin e tyre me ide të tjera. Në këtë kuadër ministri në ikje i Transporteve dhe Energjisë, Damian Gjyknuri dhe pasuesja e tij në këtë detyrë, Belinda Balluku ishin dje në auditorët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, ku zhvilluan një diskutim me drejtues dhe trupën e pedagogëve. "Në mjesdjet e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit ku bashkë me Belindën dialoguam me një grup profesorësh me synim vënie në jetë të një strategjie dhe plani masash konkrete që thellojnë ndërveprimin mes fakultetit, studentëve dhe institucioneve të fushës së mbulimit të infrastrukturës dhe energjisë", - shkroi dje Gjyknuri.



Qeveria, 84 bursa studimi për arsimin profesional në Shkodër

Për mazhorancën e majtë arsimi profesional është një zgjidhje më e mirë që garanton një treg të sigurt pune për çdo të ri. Ndaj për ti një shtysë më shumë të rinjve për të vazhduar arsimin profesional si mënyra më e mirë për të marrë një zanat, ka vendosur që të financojë studimet e këtij lloji arsimi. Për këtë qëllim dje qeveria ka miratuar vendimin për dhënie nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të 84 bursave të studimit për nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", Shkodër, nga të cilat 24 bursa studimi për nxënësit e viteve përgatitore dhe 60 bursa studimi për nxënësit e viteve të para, deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", për vitin shkollor 2018-2019. Vlera vjetore e bursës do të jetë 92 820 lekë, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e masës së bursës do të paguhet pranë bankave të nivelit të dytë për çdo nxënës/prind/përfaqësues ligjor të nxënësve përfitues.



Shitje me Ankand të Pare nga Studio Permbarimore L.D.C
"Truall + ndërtesë" me nr. pasurie 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale, 3866, me sipërfaqe totale 300 m2, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Cmimi fillestar per shitje eshte 3.107.280 Lekë.
Data e shpalljes 20.12.2018
Data e zhvillimit 15.01.2018 deri ne oren 16:00
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

**KUVENDI
ZGJIDHJA**

Bujar Leskaj i dorëzon detyrën Lindita Latit. Vendimi, me pëlqimin e faktorëve politikë

**Kreu i KLSH-së/ Zbardhet pakti,
kompetencat te drejtoresha**

Kalimi i detyrës te nënkryetari, antiligjor

Bujar Leskaj është larguar nga detyra e kreut të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ashtu siç edhe kishte bërë të ditur më parë, ai nuk garoi për një mandat të dytë, ndërsa nuk ka pranuar që të vazhdojë detyrën deri në ardhjen e kryetarit të ri të KLSH-së. Njëpërmjet një vendimi të firmosur prej vetë atij dhe të publikuar në Fletoren Zyrtare të datës 8 janar, Leskaj ia ka kaluar kompetencat drejtoreshë së përgjithshme, Lindita Latit, ish-kryetare e Autoritetit të Konkurrencës për shumë vite. "Vendosa delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit të zëvendëskryetarit i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, znj. Lindita Lati (Milo) nga data e botimit në Fletoren Zyrtare deri në paraqitjen në detyrë të kryetarit të ri të KLSH-së", thuhet në vendimin e Bujar Leskajt. Por ndonëse për nxjerrjen e këtij vendimi ai deklaroi se bazohet në disa ligje dhe praktika të tjera ndërkombëtare, kalimi i kompetencave të drejtimit të nënkryetarit duket se është një akt mirëfilli joligjor. Kjo pasi ligji i miratuar vetëm pak vite më parë "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" nuk ia jep këtë të drejtë kryetarit të KLSH-së. Madje, në nenin 24 të këtij ligji ku flitet për vazhdimësinë pas përfundimit të mandatit sanksionohet qartazi se "Pas përfundimit të mandatit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas përcaktimit të nenit 19 të këtij ligji, ky i fundit qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri". Pra, ky nen e bën detyruesë që Leskaj të qëndronte në detyrë deri në ardhjen e kreut të ri të KLSH-së. E vetmja mundësi që do të justifikonte largimin e tij sipas ligjit do të ishte pikërisht dorëheqja gjatë kohës që ai ishte në detyrë, akt të cilin ai nuk e ka ndërmarrë, megjithëse mësohet se disa kohë më parë ai i kishte bërë të ditur presidentit se nuk do të rikandidonte për një mandat të dytë. Por pavarësisht kësaj, në mungesë të një konsensusi mes presidentit dhe mazhorancës për të zgjedhur kreun e ri të KLSH-së dhe përballë dëshirës së vetë Leskajt për të mos e vijuar më detyrën, duket se palët politike dhe ato shtetërore në vend kanë rënë dakord me këtë zgjidhje ekstraligjore që ka ofruar vetë Leskaj. Në vendimin në fjalë në pikën "3" thuhet se ky vendim do të përcillet për



Bujar Leskaj



Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me ministrat

MIRËKUPITIMI

Në pikën "3" të vendimit thuhet se ai do të përcillet për publikim në Fletoren Zyrtare, "pasi kryetari i KLSH-së të kontaktojë dhe të marrë mirëkuptimin e Presidentit të Republikës, kryetarin e Kuvendit, kryetarët e grupeve parlamentare të opozitës dhe kryetarin e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave".

PRESIDENCA: SHUMË SHPEJT, EMRI I RI I KREUT TË KLSH-SË

Pas rrëzimit të kandidaturës së Vitore Tushës, Presidenti i Republikës, Ilir Meta, pritet të përzgjedhë një tjetër emër që do t'ia paraqesë Kuvendit për miratim. Këtë e bën të ditur vetë presidenti në letërën që i ka dërguar kreut të KLSH-së, ku ndër të tjera thekson se pas rrëzimit të kandidaturës së Tushës, është duke përzgjedhur një kandidat tjetër. "Presidenti i Republikës është duke vlerësuar përzgjedhjen e një kandidature të re për t'ia propozuar Kuvendit për pozicionin kushtetues të kryetarit të KLSH-së", thuhet në letër.

Meta, Leskajt: Lënia e detyrës antiligjore rrezikon institucionin

Ndonëse kreu i KLSH-së, Bujar Leskaj e bëri fakt të kryer largimin nga detyra, Presidenti i Republikës, Ilir Meta nuk ka shprehur dakordësinë e tij lidhur me këtë zgjidhje ekstraligjore të ofruar prej tij. Njëpërmjet një letre zyrtare të bërë publike dje në mbrëmje nga institucioni i Presidentit të Republikës, Meta i ka bërë të ditur Leskajt se zgjidhja që ai kishte ofruar ishte në kundërshtim me ligjit. "Përsa i takon ushtrimin të mandatit si kryetari i KLSH-së, pas përfundimit të afatit 7-vjeçar të tij, kjo çështje është e zgjidhur nga vetë ligji nr.154.2014, ku në nenin 24 parashikohet shpreh



miisht se: 'Pas përfundimit të mandatit të kryetarit të KLSH, ku i fundit qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri', thuhet në letërën e Metës. Më tej, ai i bën të ditur kreut të KLSH-së, se qëndrimi në detyrë deri në zgjedhjen e pasuesit lidhet edhe me statusin që ka ky pozicion kushtetues. "Në pikën 1 të nenit 19 të këtij ligji parash-

ikohet që KLSH-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari, ndërkohë që Kushtetuta dhe ligji garantojnë imunitetin dhe mbrojtjen e kryetarit të KLSH-së gjatë ushtrimit të funksionit", thotë presidenti në këtë letër. Më tej sipas tij, "nëse organi i KLSH-së do të përfaqësohej nga një funksionar tjetër dhe jo nga kryetari i tij, do ta zhvishte atë nga mbrojtja kushtetuese dhe ligjore që ka ky institucioni dhe në këtë mënyrë do të cenohet integriteti dhe pavarësia e tij", shpreh presidenti. Në këto kushte, presidenti shpreh vullnetin që Leskaj të qëndrojë ende në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

LIGJI

NENI 23

Mbarimi i mandatit dhe shkarkimi

- Mandati i Kryetarit të KLSH-së mbaron kur:
 - mbaron afati shtatëvjeçar i qëndrimit në detyrë;
 - dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - nuk paraqitet në detyrë për shkaqe të paarsyeshme;
 - jep dorëheqjen;
 - deklarohet i paafë për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë;
 - mësh moshën e pensionit;
 - vdes.
- Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës, kur:
 - shkel Kushtetutën ose shkel rëndë ligjin gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;
 - cilësohet nga gjykata me vendim të formës së prerë si i paafë për të kryer detyrat e tij;
 - dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - kryen akte ose sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij;
 - zbulohet raste të papajteshmërisë së funksionit të tij.
- Në rast se vendi i kryetarit mbetet vakant, Presidenti, brenda 15 ditëve, i propozon Kuvendit kandidaturën e re. Kuvendi zgjedh kryetarin e KLSH-së brenda 15 ditëve nga paraqitja e kandidaturës.

NENI 24

Vazhdimësia pas përfundimit të mandatit

- Pas përfundimit të mandatit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas përcaktimit të nenit 19 të këtij ligji, ky i fundit qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.
- Kryetari i KLSH-së rikthehet në detyrë e mëparshme dhe, në pamundësi, në një detyrë të barasvlershme me të.

publikim në Fletoren Zyrtare, "pasi kryetari i KLSH-së të kontaktojë dhe të marrë mirëkuptimin e Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, kryetarët e grupeve parlamentare të opozitës dhe kryetarit të Komisionit të Ekonomisë

dhe Financave". Pra, fakti që ky vendim është publikuar tregon qartë për një pakt të heshtur mes të gjitha palëve që detyra e kreut të KLSH-së, për sa kohë nuk është zgjedhur kryetari i ri, t'i kalojë Lindita Latit. Këtë e bën të ditur

edhe KLSH-ja në një njoftim të shpërndarë dje për mediat, ku thekson se Leskaj ka marrë pëlqimin e të gjithë faktorëve, majtas e djathtas. "Javën e fundit të dhjetorit në takime të veçanta, kryetari i KLSH-së, z.Leskaj informoi për vendimin e

delegimit të kompetencave të zv.kryetari i KLSH, znj. Lindita Milo, Presidentin e Republikës, kryetarin e Kuvendit, zv.kryetarin e Kuvendit, kryetarët e partive opozitare dhe kryetarët e grupeve parlamentare, si edhe kryetarin e Ko-

misionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë", - thuhet në njoftim. Ndërkohë që sa i përket opozitës, mësohet se ai ka takuar për këtë çështje kreun e PD-së, Lulzim Basha dhe kreun grupit të PD-së, Edmond Spaho.



Rama i shkon në zyrë, presidenti dekreton Denajn, Shahinin, Margaritin e Ballukun, pezull Cakajin

Meta dekreton 4 ministrat e rinj, nuk shkarkon Bushatin

"Mosdekreti për Cakajin, po verifikohet integriteti"

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta dekretoi dje 4 ministrat e rinj të propozuar nga kryeministri Edi Rama, ndërkohë që ende nuk ka shkarkuar Ditmir Bushatin nga posti i ministrit të Evropës dhe Punëve të Jashtme. Mësohet se mbrëmë Metës i ka vajtur në zyrë edhe vetë kryeministri Edi Rama, por me sa duket Meta nuk është bindur ende për emrin e kryediplomatit të ri. Në bazë të dekretit të Presidentit, Anila Denaj dekretohet në vend të Arben Ahmetajt si ministre e Financave dhe e Ekonomisë; Besa Shahini, ministre e Arsimit në vend të Lindita Nikollit; Belinda Balluku dekretohet si ministre Infrastruktura në vend të Damian Gjokurit dhe Elva Margariti, ministre e Kulturës në vend të Mirela Kumbaros. Kreu i shtetit ka dekretuar të gjithë emrat e ministrave të rinj të propozuar nga Rama, me përjashtim të ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushatit, i cili nuk është dekretuar si i shkarkuar nga Meta dhe emri i Gent Cakajt vijon të jetë i paautorizuar për të zënë postin e Ministrisë së Jashtme. Me dekretet e mbrëmshme, Meta ka hapur dritën jeshile për ministrat e rinj të zgjedhur nga kryeministri Edi Rama, i cili ndryshimin e tyre e njoftoi në Asambleen Kombëtare të 28 dhjetorit të vitit të kaluar. Kërkesat për ndryshime në qeveri, Rama ia dorëzoi personalisht Metës më datë 4 janar pas një takimi të shkurtër me kryeministrin dhe presidentin. Më datë 5 janar, Presidenti Ilir Meta firmosi pa hezitim lirin e të gjithë ministrave të propozuar nga Rama, me përjashtim të Ditmir Bushatit dhe dekretoi emërimin e katër prej tyre. Kreu i shtetit tha më herët se do të flasë me dekret brenda afateve të përcaktuara në ligjin themeltar të shtetit, ndërkohë që sqaroi se ishte në pritje të përgjigjeve që do të vinin nga institucionet të cilave Presidencia u është drejtuar për verifikim. "Unë po përmblush të gjitha detyrimet kushtetuese që ka Presidenti i Republikës në këtë rast. Sikurse e kemi vënë re, të gjitha propozimet janë konfirmuar menjëherë, që vijjnë nga politika, nga Kuvendi, pasi janë përfaqësues, të cilët kanë kaluar disa filtra në të kaluarën përsa i takon integritetit të tyre publik. Për të gjithë emrat e rinj ajo figurat e reja që promovohen për ministra, pra që propozohen



Presidenti Ilir Meta

MINISTRAT E DEKRETUAR

- 1- Belinda Balluku, ministre e Infrastruktura dhe Energjisë.
- 2- Anila Denaj, ministre e Financave dhe Ekonomisë.
- 3- Besa Shahini, ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- 4- Elva Margariti, ministre e Kulturës.

AFATI

"Brenda afateve dhe sa më shpejt që të jetë e mundur, jo duke pritur orët e fundit. Por kjo do të varet nga përgjigja e institucioneve që ne u jemi drejtuar. Do të bëjmë të gjitha veprimet përfundimtare dhe publike, me transparencë maksimale", u shpreh z.Meta.

DEKRETI



"Cakaj", Gjosha: S'ka përplasje Presidencë - Kryeministri

Për deputetin e LSI-së, Klajda Gjosha, posti i ministrit të Jashtëm është i një rëndësie të veçantë dhe kërkon eksperiencën e duhur. E futur në "Intervista e Ditës" me Erjon Çikun, Gjosha thekson se presidenti, në mungesë të Gjykatës Kushtetuese, është i vetmi "gardian" i Kushtetutës. Sipas saj, Meta po kërkon të bëhen verifikimet e duhura të figurës dhe integritetit të Cakajt. Ajo u shpreh se gjatë karrierës së saj në politikë, goftë edhe si ministre e Integritetit për 4 vite, nuk kishte dëgjuar për Cakajin. Gjosha tha se fakti që po vonohet dekretimi i Cakajt si ministër i Jashtëm nuk do të thotë se jemi përpara një përplasjeje institucionale mes Kryeministrisë dhe Presidencës.

Kandidati për ministër i Jashtëm, Cakaj: Opozita po dëmton interesat e Shqipërisë

Gent Cakaj, ministri i propozuar nga kryeministri Rama për të drejtuar diplomacinë shqiptare, në një intervistë për "Klan Kosova" kritikoi qëndrimin e opozitës shqiptare. Sipas Cakajt, qëndrimi i opozitës dhe bojkoti i parlamentit rrezikon hapjen e negociatave për Shqipërinë. Në muajin nëntor, Gent Cakaj ka patur vetëm rolin e këshilltarit të Kryeministrit Rama, por asokohe ai është shprehur se qëndrimi i opozitës dëmton procesin e integritetit dhe plotësimin e një prej kritereve kryesore që është reformë në sistemin ektoral. "Bojkoti parlamentar nga opozita në Shqipëri rrezikon të shndërrohet në mosrealizim të një nga kritereve kryesore për hapjen e negociatave që është përmbushja e reformës ektorale. Kjo është një shembull par excellence sesi divergjenca opozitare manifestohet në problem të theksuar të shtetit si të tillë me institucionet, axhendën dhe interesat nacionale në raport me BE", deklaroi z.Cakaj.



si të tillë po bëhet detyra normale, me shumë përgjegjësi për verifikimin e integritetit të tyre, në mënyrë që të respektojmë institucionin e ministrit, si një institucion shumë të rëndësishëm kushtetues", theksoi kreu i shtetit. I pyetur për integritetin e pasuesit të Bushatit, Presidenti Meta u tregua i rezervuar, duke thënë se do të respektojë afatet kushtetuese, duke shtuar se përgjigja e tij "do të varet nga përgjigja e institucion-

eve që iu është drejtuar Presidencës". "Brenda afateve dhe sa më shpejt që të jetë e mundur, jo duke pritur orët e fundit. Por kjo do të varet nga përgjigja e institucioneve që ne u jemi drejtuar. Do të bëjmë të gjitha veprimet përfundimtare dhe publike, me transparencë maksimale", u shpreh Presidenti Ilir Meta. Këto deklarata kreu i shtetit i bëri dje në Kavajë, në kuadër të nismës së ndërmarrë së bashku me "Aleancën për Dhurimin e Gjakut".

Samiti i dytë i Diasporës mbledhet në shkurt, qeveria miraton fondin

Në datat 28 shkurt deri në 2 mars 2019 në Tiranë dhe Lezhë do të zhvillohet Samiti i dytë i Diasporës. Në mbledhjen e djeshme të qeverisë është vendosur një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019 me vlerë 66 972 800 lekë për drejtorinë e shërbimeve qeveritare pikërisht për samitin që pritet të zhvillohet. Samiti i parë i Diasporës Shqiptare u zhvillua në nëntor 2016 në Tiranë. Në vendimin e qeverisë thuhet: "Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e vitit 2019, në zërin "Shërbime qeveritare", i shtohet fondi prej 66 972 800 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh, brenda datës 31 janar 2019, për organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës, që do të zhvillohet në datat 28 shkurt - 2 mars 2019 në Tiranë dhe Lezhë. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019. Ministria e Kulturës, brenda fushës së përgjegjësisë së vet, të bashkërendojë me Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare për organizimin e aktiviteteve social-kulturore dhe vendosjen në përdorim të monumenteve të kulturës, sipas rastit. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi".

PD, Vokshi: Mësuesit pa paga, Rama tallet ekraneve

Deputetja e Partisë Demokratike, Albana Vokshi de noncoi dje mosmarrjen e pagave nga mësuesit. Në reagimin e saj Vokshi thekson se mësuesit nuk kanë guxim që të protestojnë dot, sepse iu shkon Rama në klasë, njësoj siç iu turr sot pedagogëve. "Mësuesit pa paga. Rama tallet ekraneve për rritjen ekonomike.... Shumë mësues ende nuk kanë marrë pagat ndërsa jemi në javën e dytë të janarit. Paga e dhjetorit duhet të kishte kaluar në llogaritë bankare të mësuesve më 4 janar, por ende asnjë lajm nga "ky front". Ministri i Financave u pa tek hidhte "dosjen" në derë të kryeministrit, si për të sinjalizuar falimentin e financave të shtetit. Mësuesit s'protestojnë dot se iu shkon Rama në klasë, njësoj siç iu turr sot pedagogëve. Pa shpërblime në fundvit, me rroga që s'janë rritur asnjë qindarkë që nga 2013-a e duke dhënë mësim në kushte mesjete, mësuesit duhet të marrin borxh që të shtynj ditët derisa qeveria të vendose t'i paguajë. Ndërkohë që Ministria e Arsimit duket që ka halle të tjera të drejtuesve e nuk ka mendjen të mësuesit", -shprehet zj.Vokshi.

Prokuroria: 50-vjeçari Roland Hysi e bashkëpunëtorja akuzohen për korrupsion

I kërkoi gruas seks dhe 500 euro për t'i dhënë kujdestarinë fëmijës, pranga gjyqtarit fierak

Videoskandali në emisionin "Stop", përfundon në pranga dhe psikologja seksere, Elona Meçani

TIRANË

Gjyqtari Roland Hysi, i cili i kërkonte rryshfet dhe marrëdhënie seksuale një nënë të divorcuar në këmbim të dhënies së kujdestarisë së fëmijës së saj është arrestuar dhe nga policia e Tiranës në bashkëpunim me atë të Fierit. Gjithashtu, në pranga ka përfunduar dhe sekserja, Elona Meçani, e cila është psikologe pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Dy personat në fjalë u prangosën pas skandalit të publikuar mbrëmjen e së martës në emisionin "STOP". Me anë të kamerës së fshehtë tregohet sesi 50-vjeçari Hysi shfaqej duke marrë 500 euro rryshfet dhe i kërkonte favore seksuale një gruaje të divorcuar për t'i dhënë asaj kujdestarinë e fëmijës. Ndërsa psikologja 28-vjeçare bënte rolin e sekseres. Ndaj dy të arrestuarve rëndojnë akuzat e "Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë" dhe "Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike". Në videopërgjim gruaja denoncuese tregon gjithë kalvarin që i është dashur të përballojë, duke blerë me euro fëmijën e saj. "Drejtorja Hetimore Qendrore në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier dhe Tiranë kryen ekzekutimet e vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë Nr.5, datë 09.01.2019, e cila ka vendosur masën e sigurisë 'Arrest me burg' për shtetasit: R.H., 50 vjeç, banues në Tiranë, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier dhe E.M., 28 vjeçe, banuese në Fier, me detyrë psikologe, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier", thuhet në njoftimin zyrtar për mediat të Policisë së Shtetit. Ndërkaq, mësohet se gjykata ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj Roland Hysit dhe Elona Meçanit, të cilët ndodhen të ndaluar në Drejtorinë Vendore të Policisë së Tiranës. Kamera e fshehtë e "Stop" tregoi se nëna e divorcuar takohet në ambientet e një hoteli në Fier me gjyqtarin Hysi, atje ku jepte edhe shumën prej 500 eurosh për të marrë vendimin në favor të saj. Por gjyqtari Hysi nuk mjaftojë vetëm me paratë, pasi kërkonte edhe favore seksuale prej saj. Por pas hedhjes së shortit, çështja do të shqyrtohej nga gjyqtari Taulant Banushi dhe sërisht psikologja Elona Meçani luajtë rolin e sekseres dhe denoncueses iu desh të pagante rryshfet edhe 500 euro të tjera.

PROKURORIA
Pas transmetimit të videoregjistrimit ku gjyqtari i Fierit, Roland Hysi kërkonte rryshfet e marrëdhënie seksuale nga një nënë e divorcuar me qëllim dhënien e kujdestarisë së fëmijës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda njoftoi dhe (para arrestimit) nisjen e procedimit penal ndaj tij. "Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, duke u nisur nga pamjet filmike të transmetuara në datën 08.01.2019 në emisionin 'Stop' të televizionit 'Klan', kryesisht, ka regjistruar procedim penal për veprat penale 'Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë' dhe 'Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike'".

erit, Roland Hysi kërkonte rryshfet e marrëdhënie seksuale nga një nënë e divorcuar me qëllim dhënien e kujdestarisë së fëmijës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda njoftoi dhe (para arrestimit) nisjen e procedimit penal ndaj tij. "Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, duke u nisur nga pamjet filmike të transmetuara në datën 08.01.2019 në emisionin 'Stop' të televizionit 'Klan', kryesisht, ka regjistruar procedim penal për veprat pen-


nale 'Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike' dhe 'Korrupsionit pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtë-

sisë', të parashikuara nga nenet 245/1 dhe 319/ç të Kodit Penal. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë së Shtetit janë duke u kryer veprimet e nevojshme hetimore,

me qëllim hetimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe të përgjegjësisë penale të personave të përfshirë", thuhet në njoftimin zyrtar të organit të akuzës.



REAGIMI



Skandali me gjyqtarin e Fierit, KLGJ: Nxisim verifikimin e ngjarjes

TIRANË - Këshilli i Lartë Gjyqësor ka reaguar pas video përgjimit në emisionin "Stop" për gjyqtarin e Fierit. "Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi u njoh me videon e shfaqur në mbrëmjen e datës 08.01.2019, në emisionin investigativ 'Stop', televizioni kombëtar 'Klan' shpreh shqetësimin dhe indignatën e thellë për ngjarjen dhe për implikimin e mundshëm të gjyqtarit apo gjyqtarëve të përmendur në këtë emision. Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke vlerësuar sjelljet dhe veprimet e gjyqtarit në raport me ligjin, nxit shqyrtimin dhe verifikimin e plotë të gjithë kësaj ngjarjeje nga strukturat përkatëse. Shkeljet e rënda të etikës dhe që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit ishin arsye për të cilën reforma në drejtësi doli si domosdoshmëri dhe do të jetë arsye që kjo reformë, me të gjitha institucionet e reja të sapongritura të vijojë përpara betejën ndaj çdo lloj korrupsioni të shfaqur; në të gjitha nivelet, me qëllim final sigurimin e sundimit të ligjit, pavarësisht dhe eficientë e gjyqësorit", thuhet ndër të tjera në njoftimin e KLGJ-së.

PERGJIMET E REJA

Në videon e re të transmetuar në emisionin "STOP", në Tv Klan, gjyqtari Hysi thotë se arrin të shikojë edhe ngjyrën e të brendshmeve dhe se atij nuk i shpëton asgjë. Kjo sipas tij e bën "origjinal".

Gjyqtari Roland Hysi: Kush ka besim te mua, ka fituar botën. Kam qenë 25 vjeç kryetari i Gjykatës së Bajram Currit...kam qenë 25 vjeç... 93-'95 dhe kur bridhja me 4 varëse floriri... dhe kur bëja stërvitje dhe kur i kisha të gjitha..., e di si më rrinin nga mbrapa...? Në këmbë. Unë i trajtoj njerëzit si zyrtar dhe tërë jetën më kanë ardhur nga mbrapa me luteshin edhe sot e kësaj dite të njëjtën gjë kam...Më dëgjo një çikë Landin! Vetëm më dëgjo...! Të q... dhe më beso për këtë...! Të q... të gjithë më luten! Të të garantoj! Jam një mashkull i devotshëm, jam një mashkull potent dhe me autoritet!...

Nga ty, çfarë dua unë, në kuptimin e mirë të fjalës?! Ti rri rehat, mos më thuaj asnjë gjë! Atë, që e ndjen...e di pse po ta them? Se do ndihesh më rehat. Fry! Nxirre atë stresin! Jetoje me kënaqësi

momentin! Të lutem... shijojë jetën! E di sa më vijnë mua? E kam shkelur botën më shpejt, para teje unë. Kam qenë në '94 në Holandë, Rotterdam. Kam pas lekë më shumë se sa mund të kenë të gjithë shqiptarët bashkë. Ti, do të bësh çejf me mua?

Denoncuesja: Më ke thënë: Ta di ngjyrën e reçipetave!

Gjyqtari Roland Hysi: Jo! Ta thashë për tjetër gjë...mua s'më shpëton asnjë gjë, të thashë. Më shikon edhe syri përtej asaj që nuk dallohet, madje mund të të di edhe ngjyrën e të brendshmeve, që nuk mund të shikohen, thashë.

Denoncuesja: Po!
Gjyqtari Roland Hysi: Atëherë, atëherë dëgjo Landin! Nuk jam nga ata njerëz, që të të peshoj unë ty, a je për seks apo jo? Sa femra më vijnë mua...! Jo, jo, nuk po ta them, që për të të thënë, që s'je në radhë apo jo. Absolutisht! Biseda ishte komplet në këtë kontekst. Unë i shikoj çdo gjë në sallë të gjyqit dhe kjo më bën atë, origjinalitetin tim, Landin, ky gjyqtari këtu, ky gangsteri. I kam të gjitha, pa diskutim, ta thashë vetë unë...

EMIGRANTËT NË ITALI NDRYSHIMET PËR 2019

Drejtuesja e "INAS Albania": Lehtësim procedurash për legalizimin e përkthimit

Voltiza Duro

Të gjithë ata që dëshirojnë të aplikojnë për një vizë pune në Itali, tashmë mund të njihen me kushtet dhe dokumentacionin që nevojitet për të punuar në këtë shtet. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', drejtuesja e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj tregon kriteret dhe dokumentet që duhet të dorëzohen kandidatët. Ajo shton se kërkesat mund të paraqiten duke filluar nga tre muaj përpara udhëtimit të parashikuar; në një kohë që viza do të lëshohet me vlefshmëri nga data e fillimit të marrëdhënies së punës. Aliaj rekomandon që takimi të caktohet në një datë të përshtatshme përpara datës së nisjes e shton se të gjitha dokumentet dhe deklaratat e hartuara në gjuhë shqipe të lëshuara nga autoritetet lokale, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën italiane dhe të apostiluara nga Ministria e Punëve të Jashtme Shqiptare. Drejtuesja e patronatit INAS thekson më tej se prej 1 janarit të këtij viti nuk do të jetë e nevojshme që të kërkohet legalizimi i përkthimit pranë autoriteteve konsullore italiane në Shqipëri.

Beskida Aliaj: Si të aplikoni për vizë pune në Itali, hapat që duhen ndjekur

"Dokumentacioni që duhet të dorëzoni në gjuhën italiane"



3

MUAJ
"Kërkesat mund të paraqiten duke filluar nga tre muaj përpara udhëtimit të parashikuar; viza do të lëshohet me vlefshmëri nga data e fillimit të marrëdhënies së punës. Rekomandohet që takimi të caktohet në një datë të përshtatshme përpara datës së nisjes", thotë Aliaj.

PROCEDURA PËR LEGALIZIMIN E PËRKTHIMEVE

- Përkthimi do të kryhet nga një përkthyes i njohur firma e të cilit është deponuar pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- Përkthyesi do të vendosë në përkthim këtë diciturë: "Deklarohet se ky përkthim është i njëjtit me tekstin origjinal në gjuhën shqipe dhe se është kryer nga "Emri dhe Mbiemri", përkthyes i njohur i akredituar pranë Ministrisë së Drejtësisë shqiptare."
- Do të vendoset firma dhe vula e përkthyesit të njohur.
- Në bazë të nenit 65 të Ligjit nr. 7829 datë 01.06.1994, një noter shqiptar do të deklarojë vërtetësinë e nënshkrimit dhe statusin ligjor të përkthyesit të njohur.
- Mbi dokumentin dhe përkthimin do të vendoset vula "apostile" nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë.
- Dokumenti origjinal i pajisur me apostile dhe i shoqëruar nga përkthimi po ashtu i pajisur me apostile, mund të paraqitet pranë Autoriteteve italiane në Itali.

DOKUMENTACIONI PËR KËRKESËN E VIZËS

- Formulari i kërkesës për vizë (duhet përdorur një formular për secilin aplikant për vizë, i plotësuar në secilën pjesë të tij dhe i firmosur);
- Pasaporta e vlefshme (skandanca e pasaportës duhet të jetë të paktën tre muaj pas mbarimit të afatit të vizës që kërkohet);
- Një fotokopie e pasaportës; 2 fotografi të kohëve të fundit të formatit taser;
- Certifikatë personale me apostile dhe përkthim në italisht (vetëm nëse është kërkesa e parë për vizë, për të verifikuar kompetencën territoriale të Kancelarisë Konsullore të Ambasadës së Tiranës).

KOSTO

Procedura e re do të ketë kosto më të ulët se shifra 3030 lekë që kushtonte më parë ndërsa koha e marrjes së shërbimit do të jetë më e shkurtër. Kujtojmë se shtetasit shqiptarë kanë gjithsesi mundësi që të kryejnë përkthimin zyrtar të dokumenteve nga përkthyes të njohur në Itali.

nga "Emri dhe Mbiemri", përkthyes i njohur i akredituar pranë Ministrisë së Drejtësisë shqiptare." Do të vendoset firma dhe vula e përkthyesit të njohur. Në bazë të nenit 65 të Ligjit nr. 7829 datë 01.06.1994, një noter shqiptar do të deklarojë vërtetësinë e nënshkrimit dhe statusin ligjor të përkthyesit të njohur. Mbi dokumentin dhe përkthimin do të vendoset vula "apostile" nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Dokumenti origjinal i pajisur me apostile dhe i shoqëruar nga përkthimi po ashtu i pajisur me apostile, mund të paraqitet pranë Autoriteteve italiane në Itali.

A do të ketë kosto më të ulët kjo procedurë?

Procedura e re do të ketë kosto më të ulët se shifra 3030 lekë që kushtonte më parë ndërsa koha e marrjes së shërbimit do të jetë më e shkurtër. Kujtojmë se shtetasit shqiptarë kanë gjithsesi mundësi që të kryejnë përkthimin zyrtar të dokumenteve nga përkthyes të

njohur në Itali.

Si mund të kryhet aplikimi për një vizë pune në shtetin Italian?

Kërkesat mund të paraqiten duke filluar nga tre muaj përpara udhëtimit të parashikuar; viza do të lëshohet me vlefshmëri nga data e fillimit të marrëdhënies së punës. Rekomandohet që takimi të caktohet në një datë të përshtatshme përpara datës së nisjes. Formularët për kërkesën për vizë dhe modulët në përdorim mund të shkarkohen nga site i Ambasadës ëëë.ambtirana.esteri.it (në veçanti konsultoni sektorët "viza" dhe "modulistikë") si dhe shpërndahen pa pagesë në hyrje të Kancelarisë Konsullore.

Cili është dokumentacioni që duhet të paraqesin të interesuarit?

Dokumentacioni që duhet të paraqitet për kërkesën e vizës për punësim përfshin: formularin e kërkesës për vizë (duhet përdorur një formular për secilin aplikant për vizë, i plotësuar në secilën pjesë të tij dhe i fir-

mosur); pasaporta e vlefshme (skandanca e pasaportës duhet të jetë të paktën tre muaj pas mbarimit të afatit të vizës që kërkohet); një fotokopie e pasaportës; 2 fotografi të kohëve të fundit të formatit taser; certifikatë personale me apostile dhe përkthim në italisht (vetëm nëse është kërkesa e parë për vizë, për të verifikuar kompetencën territoriale të Kancelarisë Konsullore të Ambasadës së Tiranës).

A duhet të përkthehet në italisht dhe të ketë vullën apostile dokumentacioni i sipërpërmendur?

Të gjitha dokumentet dhe deklaratat e hartuara në gjuhë shqipe të lëshuara nga autoritetet lokale, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën italiane dhe të apostiluara nga Ministria e Punëve të Jashtme Shqiptare. Certifikatat e gjendjes civile duhet të jenë të lëshuara nga jo më shumë se 6 muaj.

Në momentin që individit dorëzon dokumentacionin, a është i garantuar lëshimi i vizës?

Përfaqësia Diplomatike ose Konsullore ka të drejtën të kërkojë dokumentacion shtesë në rast nevojë. Nënvizohet se paraqitja e dokumentacionit të kërkuar nuk sjell domosdoshmërisht lëshimin e vizës.

A do të ketë ndonjë lehtësim procedurash në vitin 2019 për emigrantët shqiptarë në Itali?

Ashtu si ka njoftuar edhe ambasada e Italisë në Tiranë, për t'u ofruar një shërbim më të mirë shtetasve në aspektin ekonomik dhe në lidhje me lehtësimin e procedurave, duke filluar nga data 1 janar 2019, do të vendoset vula apostile edhe për përkthimet e njohura. Për të qenë të vlefshme në Itali, dokumentet e lëshuara nga Autoritetet shqiptare në Shqipëri duhet të jenë të pajisura me vula apostile të dyfishtë të vendosur nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë: mbi dokumentin origjinal në gjuhën shqipe dhe mbi përkthimin në e njohur në gjuhën italiane. Pra, nuk do të jetë e nevojshme që të kërkohet legalizimi i përkthimit pranë autoriteteve konsullore italiane në Shqipëri.

Cila është procedura që duhet ndjekur për legalizimin e përkthimeve?

Përkthimi do të kryhet nga një përkthyes i njohur firma e të cilit është deponuar pranë Ministrisë së Drejtësisë. Përkthyesi do të vendosë në përkthim këtë diciturë: "Deklarohet se ky përkthim është i njëjtit me tekstin origjinal në gjuhën shqipe dhe se është kryer

Kryeregjistruesi: Nga 31 marsi, "fast track" edhe në 11 zyrat rajonale

Pjetri: Hipotekat, 9 shërbimet që i përfitoni brenda 24 orësh

Lista me dokumentet e kadastrës dhe çmimet përkatëse

Nga 31 marsi shërbimet e shpjeta përmes sistemit të ri 'fast track' do të implementohen në të gjithë Shqipërinë, në 11 zyrat kryesore rajonale. Kështu deklaroi kryeregjistruesi Valdrin Pjetri, i cili gjatë një intervistë për Klan thotë se në Tiranë sistemi është shumë efektiv dhe brenda 24 orësh merrni dokumentin që ju nevojitet. Që në nëntor të këtij viti, zyrat e Hipotekës në Tiranë kanë nisur aplikimin e sistemit të ri "fast track", që do të thotë shërbim i shpejtë për 9 shërbimet kryesore që ofron Hipoteka: marrja e kartelës së pasurisë, bllokime të pronësisë nga bankat apo kalim pronësie. Me sistemin e ri pretendohet ulja e korrupsionit i cili ka qenë në normë të lartë në zyrat e hipotekave. Afërsisht gjysma e aplikimeve të qytetarëve që shkojnë në Hipotekë lidhen me shërbimet që ndodhen në platformën "fast track".

Z.Pjetri, sa ka qenë koha e vonesave dhe sa njerëz ka prekur kjo vonesë për marrjen e dokumenteve të



Hipoteka e Tiranës



Kryeregjistruesi Valdrin Pjetri

ndryshme në Hipotekë?

Nga kontrolli i ushruar në vitin 2017, u gjetën vonesa për 80 mijë qytetarë, nga 170 mijë aplikime totale. Kjo shifër lidhet fort me imazhin që Zyrat e Regjistrimit të Pasurisë japin për qytetarët dhe perceptimin e korrupsionit. Ndaj u mendua zgjidhja me sistemin 'fast track', i cili lehtëson procedurën e marrjes së doku-

menteve për 9 shërbime kryesore që ofron hipoteka. **Si kryhet procedura për marrjen e dokumenteve që i nevojiten qytetarëve dhe sa janë afatet?** Qytetarët duhet të drejtohen në sportelin e duhur dhe të aplikojnë për kryerjen e shërbimit. Platforma e re teknologjike bën që shërbimi të mos vonohet me shumë se 24 orë për çdo

qytetar që kërkon një përgjigje të shpejtë nga zyrat e regjistrimit të pasurive, çdo vonesë monitorohet nga një grup punonjësish dhe vetë drejtuesit e institucionit. Qytetarët e Tiranës tashmë nuk duhet të njojnë as punonjësin e Hipotekës as regjistruesin e Tiranës as kryeregjistruesin për të marrë në kohë reale këto shërbime. Çdo gjë është në

SHËRBIMET DHE ÇMIMET

- Regjistrimi i kontratës së shitjes. 7,000 lekë
- Regjistrimi i kontratës së dhurimit. 7,000 lekë
- Regjistrimi i deklaratës për heqjen dorë nga pronësia. 1600 lekë
- Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale. 2000 lekë
- Lëshim kopje të kartelës së pasurisë. 2.000 lekë
- Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucioni tjetër kredidhënës për kredi me vlerë deri në 1.000.000. 10.000
- Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucioni tjetër kredidhënës për kredi me vlerë nga 1.000.000 në 10,000,000. 30.000
- Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucioni tjetër kredidhënës për kredi me vlerë mbi 10,000,000 lekë. 50.000 lekë
- Regjistrim apo fshirje të kontratave të tjera hipotekore. 2.000

sistem dhe vonesa të gjurmë atje. Disa nga shërbimet kryhen edhe brenda 6 orëve. **Sa i sigurt është shërbimi që ju thoni, pra garancia kohore për ta marrë këtë shërbim?** Është sistemi ynë IT që monitoron procesin dhe dhënien në kohë të këtyre shërbimeve. Ne e besojmë sistemin ndaj e krijuam. **Do shtrihet ky shërbim**

edhe në qytete të tjera apo do mbesë vetëm në Tiranë? Nga 31 marsi shërbimet e shpjeta përmes sistemit të ri do të implementohen në të gjithë Shqipërinë, në 11 zyrat kryesore rajonale. Ky është synimi ynë dhe do e realizojmë pasi qytetarët në të gjithë vendin kanë të drejtën të trajtohen njësoj edhe për sa i përket marrjes së shërbimeve hipotekore.

Ndryshime edhe në rregulloren "Për kapitalin rregullator të bankës"

Kush është zëvendësguvernatorja e re e Bankës së Shqipërisë

Luljeta Minxhozi është zgjedhur nga Këshilli Mbikëqyrës në funksionin e zëvendësguvernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë. Prof. Dr. Luljeta Minxhozi është diplomuar në degën Ekonomikë Politike në Universitetin e Tiranës. Në 1990 fiton Gradën Shkencore Kandidat i Shkencave në Universitetin e Tiranës e më pas, në vitin 1993 fiton Gradën Shkencore në Milano. Në vitin 1996 merr gradën shkencore "Doktor" ndërsa në vitin 1999 fiton titullin "Profesor i Asociuar". Prej vitit 2011 mban titullin shkencor "Profesor". Prof. Dr. Luljeta Minxhozi ka një eksperiencë të gjerë si pedagogje për lëndët e ekonomikut në Shqipëri, Danimarkë e Itali. Referuar njoftimit të Bankës së Shqipërisë, në mbledhjen e



sotme Këshilli Mbikëqyrës analizo veprimtarinë e tij për vitin 2018 dhe miratoi programin e punës për vitin 2019, së bashku me kalendarin e mbledhjeve që do të

zhvillojë gjatë këtij viti. Një vendim tjetër i miratuar është ai për disa ndryshime në rregulloren "Për kapitalin rregullator të bankës". "Këto ndryshime synojnë

përafrimin e vazhdueshëm të kërkesave të Bankës së Shqipërisë, me kërkesat e Bazel III, për raportet e kapitalit. Kështu, raportet minimale (përkatësisht të kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të parë) do të përshtaten në mënyrë përpjesëtimore me nivelin minimal të kërkuar të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit (12%) njofton Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës u njoh dhe me informacione të tjera të lidhura me veprimtarinë e përditshme funksionale dhe operacionale të Bankës së Shqipërisë.



Ngeg rimbursimi i TVSH-së për fasonët, Financat: Fatura, 1.8 mld lekë

Kërkesat e bëra nga industria me material porositi si për rimbursimin e TVSH-së, nuk kanë marrë zgjidhje. Produuesit e veshjeve dhe të këpucëve vijojnë ende të përballen me probleme të rënda financiare, ku duke shtuar edhe goditjen nga zhvlerësimi i monedhës së përbashkët euro, rrezikojnë shkurtim të vendeve të punës e deri në faliment. Ndërsa, nga ana tjetër, ministri i Financave, Arben Ahmetaj e ka cilësuar të padëmshme vlerën e rimbursimit ndaj bizneseve, në rreth 1.8 miliardë lekë. Në fund të vitit që lamë pas, fasonët kërkuar nga qeveria marrjen e masave të menjëhershme për të parandaluar drejtimin që ka marrë kjo industri. Industria me material porositi punëson mijëra individë në mbarë vendin, pjesa më e madhe e të cilëve nuk kanë arsimein e duhur dhe që kanë vështirësi në tregun e punës.

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Përmbartore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 11.02.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Apartament, Nr.pasurie:7248 e ndodhur në Tiranë, Rruga "Ifrit Tomini" me sipërfaqe totale 138.34 m², Zona Kadastrale Nr.8260, Vol.16, Fq.64 në pronësi të znj.Kristina Xhaferri Shala me vlerë fillestare në ankand 61,992 (Gjasthedhjetë e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) EUR. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Njoftim për shitje me ankand
Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë të pasurisë të palles debitorë Shoqëria "ARNI" sh.p.k. Pauria që delane ankand te pare përbehet nga : "Apartament", me Nr pasurie 69/11/ND +1-14 ndodhur ne Rr "Dodona", Hyrja nr.1, Kati 13 Ap 14, Oriku e regjistruar ne ZVRPP- Vlore, Z K Nr.2832, volumi 16, faqe 120, me sipër 43 m². Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 1.920.000 lekë Ankandi do të zhvillohet në datë 25.01.2019 në orën 15:00 në selisë Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Kontakto 0672082543 Iiir dervishaj@yahoo.com faqen WEB www.powerjustice.al.com

Shtëpia në Surrel, PD publikon dokumentet e deklarimit të pasurisë së kryeministrit

Valentina Madani

PD: Rama nuk e justifikon banesën as me paratë e gruas

"Vlera e shtëpisë 400 mln lekë, e deklaruaran 80 mln"

Partia Demokratike akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se ka gënjyer me pasurinë e deklaruar që në momentin që mori detyrën e kreut të qeverisë. Partia Demokratike publikoi dje dokumentet zyrtare që provojnë, sipas saj, se të ardhurat e deklaruarat të Edi Ramës dhe të ardhurat e gruas së tij nuk kalojnë vlerën e 100 milionë lekëve dhe nuk justifikojnë dot vlerën 400 milionë lekë të shtëpisë në Surrel. Deputetja Orjola Pampuri publikoi një dokument, që sipas PD-së tregon të ardhurat e deklaruarat deri në 100 milionë lekë të çiftit kryeministrot, shumë herë më pak se kostot e banesës. Sipas PD-së, Rama dhe bashkëshortja e tij kishin deklaruar 80 milionë lekë pasuri, ndërkohë që banesa e tyre në Surrel është deklaruar se vlen 400 milionë lekë. Ndaj, dokumentet zyrtare provojnë se të ardhurat e deklaruarat të kryeministrit Edi Rama dhe të gruas së tij nuk e kalojnë vlerën e 100 milionë lekëve, ndaj edhe nuk justifikojnë dot 400 milionë lekë të shtëpisë në Surrel. "Në vitin 2011, përpara njëse së ndërtimit të shtëpisë, Edi dhe Linda Rama kanë deklaruar se të dy bashkë zotërojnë rreth 80 milionë lekë. Në vitin 2012-ën, Edi Rama ndërton shtëpinë e tij në Surrel dhe kur mori detyrën e kryeministrit një vit më vonë, deklaroi se ka shpenzuar plot 400 milionë lekë për ndërtimin e saj, pra plot 5 herë më shumë sesa kursimet që kishte gjendje çifti Rama", theksoi zj. Pampuri. Deputetja e PD-së akuzoi se, "Edi Rama i ka gënjyer shqiptarët për pasurinë e tij që ditën e parë, kur u ul në karriqen e kryeministrit të vendit. PD akuzon më tej se: "Sipas deklarimit të pasurisë që vetë kanë dorëzuar në 2013-ën, rezultoi se pasi kanë deklaruar shtëpinë 400 milionë lekë, pra pasi kanë shpenzuar kursimet e jetës 80 milionë lekë, Edi dhe Linda Rama jo vetëm nuk kanë deklaruar borxh, por pasuria e tyre është shtuar, duke deklaruar se kanë gjendje plot 92 milionë lekë. Dokumentet zyrtare faktojnë se të ardhurat e Edi Ramës më 2013-ën nuk e justifikojnë dot vlerën 400 milionë lekë të shtëpisë superluksoze në Surrel". Prej ditësh, Partia Demokratike ka akuzuar kryeministrin Edi Rama për mungesë transparence në deklarimin e pasurisë. Sipas PD-së, për Kryeministrin e Shqipërisë ka sot vetëm një pyetje: "Ku i gjeti Edi Rama 400 milionë lekë për ndërtimin e shtëpisë superluksoze në Surrel, kur bashkë me gruan kishte deklaruar vetëm 80 milionë lekë kursime? Ka ardhur koha që Edi Rama i oxhakut 18 mijë euro të përgjigjet dhe të mos fshihet më pas fustanit të gruas".




AKUZA

Sipas PD-së, Edi Rama dhe bashkëshortja e tij kishin deklaruar 80 milionë lekë pasuri, ndërkohë që banesa e tyre në Surrel është deklaruar se vlen 400 milionë lekë.

SAKTESIM

Në shkrimin e datës 09.01.2019, në Gazetën Shqiptare, në kryetakullin "Kompensimi i Pronave ja si ndryshon procedura", dëshirojmë të sqarojmë se titulli kryesor nuk përputhet krejtësisht me përmbajtjen e shkrimit, në faqen 6, për sa i përket deklarimit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, për ndryshimet në Ligjin "Për Avokaturën e Shtetit". Dëshirojmë të informojmë se, procedura e kompensimit të pronave nuk ka ndryshuar dhe vazhdon të funksionojë sipas parashikimeve të Ligjit 133/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Shkrimi i mësipërm ka të bëjë me ndryshimet më të fundit në Ligjin "Për Avokaturën e Shtetit", i cili ndër të tjera ka formalizuar dhe theksuar procedurën e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



Dhuna ndaj grave, PD: Forcimi i ligjit, një mision i pamundur

Pas ngjarjeve të rëndë ku kanë humbur jetën disa gra e vajza, reagoi dje edhe deputetja demokratke, Orjola Pampuri. Në një shënim në faqen e saj në "Facebook", ajo shkruan se, "nuk ka instrumente, ligji nuk është aq i fortë përballë dhunësve, duhet të merren masa që urdhrat e mbrojtjes të zhvendosin bashkëshortin dhunues nga banesa, edhe pse kjo e fundit është në pronësi të tij, duke e vendosur në qendra rehabilitimi, ku të marrë asistencën e duhur psikosociale. Hallkat e sistemit të referimit sot janë fasadë, forcimi i ligjit për dhunën në familje mbetet ende një mision i pamundur", shkruan deputetja e PD-së.

Unaza, Balliu thirrje Ramës: Anulo projektin, ose banorët të vijnë në Surrel

Deputetët e opozitës edhe mbrëmë ishin në krah të banorëve të Unazës së Re. Deputeti Klevis Balliu i bëri thirrje Ramës që të anuloi projektin, ose banorët do t'i shkojnë në shtëpinë e tij në Surrel. "Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë këtu. Po të japim afat Edi Rama të bësh kthesë, anulosh projektin, në të kundërt këta qytetarë dhe të gjithë Shqipërinë do t'i kesh në Surrel për të të anuluar ty njëherë e mirë".

THIRRJA

"Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë këtu. Po të japim afat Edi Rama të bësh kthesë, anulosh projektin, në të kundërt këta qytetarë dhe të gjithë Shqipërinë do t'i kesh në Surrel për të të anuluar ty njëherë e mirë".

tuar Shqipërinë nga fara e keqe komuniste që mbolle, me rilindjen tënde të korruptuar dhe inkriminuar", deklaroi z.Balliu. Deputeti i LSI, Endrit Braimllari akuzoi kryeministrin Rama se kërkon të përfitojë në kurriz të banorëve të Unazës së Re. "Edi Rama kërkon të



në zonën e Unazës së Re, dy net më parë zgjodhën të bënin një lëvizje ndryshe. Ata shkuan mbrëmjen e së martës dhe protestuan afër shtëpisë së Edi Rames në Surrel. Protestuesit mbajtën me vete pishtarë, duke iu afruar shtëpisë së Ramës, por nuk u lejuan nga policia. Bashkë me ta ishin edhe deputetët të opozitës.

ARRSH: Bëni kujdes në rrugë, ja akset më problematike nga veriu në jug

Vendi "pushtohet" nga dëborë e acari, pezullohet mësimi në 280 shkolla

MB: Situata më problematike në qarqet Korçë, Gjirokastrë, Shkodër, Dibër dhe Kukës

Moti i keq, shoqëruar me reshje dëborë dhe temperature të ulëta ka krijuar situatë problematike në disa zona të vendit tonë. Mijëra banorë në zonat e thella malore, në veri dhe jug të vendit janë izoluar. Burime zyrtare nga ARRSH dje bënë me dije se rrugët nacionale janë të kalueshme, ndërsa gjendja në të gjitha segmentet rrugore nga Qafë-Mali deri në Qafë-Muzinë është e rënduar për shkak të temperaturave të ulëta dhe reshjeve intensive të borës. Ndërsa, burime zyrtare nga Ministria e Mbrojtjes deklaruan se prefekturat më problematike me prezencë të shtuar dëborë dhe vështirësi në rrugë janë Korça, Gjirokastra, Shkodra, Dibra dhe Kukësi. Si pasojë e motit të keq është pezulluar mësimi në 280 shkolla. Lajmi është konfirmuar nga vetë Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve përmes një njoftimi të shpërndarë për mediat. Mes tjerash, ministria sqaroi ditën e djeshme se orët e humbura për shkak të kushteve të vështira atmosferike do të zëvendësohen në ditët në vijim. "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nisur nga situata atmosferike në vendin tonë për datën 9 janar 2019 bën me dije se disa Drejtori Arsimore Rajonale kanë marrë vendimin për pezullimin e mësimi në disa shkolla. Sipas raportimeve në Ministrinë e Arsimit, për funksionimin e institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar është pezulluar mësimi për sot në 5 drejtori dhe zyra arsimore si Gjirokastrë, Librazhd, Pukë, Tepelenë dhe Përmet. Ndërkohë që edhe në disa zyra të tjera arsimore ku disa shkolla ndodhen në zona malore, mësimi nuk është zhvilluar. Në total janë rreth 280 shkolla kryesore dhe vartëse që nuk kanë nisur procesin mësimor për shkak të kushteve të motit", thuhet në njoftim. Po sipas MARS, "në zonat e tjera të vendit mësimi vijon normalisht. Për ato shkolla ku dje mësimi është pezulluar, zëvendësimi i orëve do të bëhet në ditët në vijim. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është në kontakt të vazhdueshëm me drejtorët e Drejtorive Arsimore, drejtues shkollash dhe prefektët e qarqeve për monitorimin dhe ndjekjen e situatës në terren".



Rrugët e bllokua nga bora



Çako, apel shoferëve: Vendosni zinxhirë, respektoni rregullat

KORÇË - Drejtori i Përgjithshëm i Emergjencave Civile, Haki Çako së bashku me kreun e ARRSH-së kanë inspektuar situatën e rrugëve në Korçë pas reshjeve të borës. Në një lidhje telefonike për "News 24", Haki Çako tha dje se situata nuk është emergjente, por e vështirë. Ai u bëri apel drejtuesve të mjeteve që të vendosin zinxhirët dhe të respektojnë rregullat e qarkullimit. "Jemi në situatë të vështirë, por jo në situatë emergjente. Po vlerësojmë situatën hap pas hapi, më e vështirë gjendja është në zonat e thella malore. Po mbajmë kontakte me të gjithë prefektët dhe jemi në gatishmëri për të përbaluar çdo të papritur të motit. Kompania kontraktore vazhdon punën për hapjen e rrugëve dhe hedhjen e skories. Po vlerësojmë situatën dhe jemi gati për të ndërhyrë edhe me mjetet tona. Më problematik paraqitet rrethi i Korçës dhe Pukës. U bëjmë apel të gjithë drejtuesve të mjeteve të përdorin zinxhirët", - tha Çako.



kësaj, ka ende segmente që vijojnë të jenë nën pushtetin e ngricave. Sipas ARRSH-së, në rajonin verior Shkodër gjatë natës që shkoi ka pasur reshje dëborë me intensitet. Kontraktorët kanë bërë pastrimin dhe trajtimin me kripë të të gjitha segmenteve rrugore. Qarkullimi kryhet pa zinxhirë në akset Kukës-Bushtricë dhe Kukës-Ura e Zapidit, Qafë Laç-Koman, Koplik-Bogë, Dedaj-Razëm. Në segmentin Skuraj-Burrel-Klos-Bulqizë-Peshkopi, lëvizja e mjeteve kryhet pa zinxhirë, por rekomandohet përdorimi i zinxhirëve dhe gomave të

borës, pasi reshjet po intensifikohen. Në rrugë Ura e Cerencit-Steblevë, po punohet me borëpastruese dhe fadroma për pastrimin e rrugës dhe qarkullimi kryhet me zinxhirë vetëm në pjesën fundore. Në segmentet e mëposhtme, qarkullimi kryhet me zinxhirë: Qafë Mali-Fierzë (ka reshje me intensitet, rreth 20 cm borë); Qafë Qelë-Pukë-Fushë Arrëz-Kukës, Shkodër-Hani i Hotit dhe Ura e Topojanit-Dogana Billatë. Firmat e mirëmbajtjes po punojnë intensivisht me borëpastruese e trajtimin me kripë për pastrimin total të këtyre segmenteve.

SKRAPAR

Moti i keq ka shkaktuar jo vetëm bllokime të akseve rrugore, por edhe probleme me furnizimin e energjisë elektrike në disa zona të vendit. Situatë problematike paraqitet në zonën e Skraparit, ndërsa OSHEE ka dalë në terren dhe po punon intensivisht për riparimin e defekteve, të cilat janë shkaktuar nga reshjet e dëborës dhe moti i keq.

Rruga e bllokuar nga bora, 25-vjeçarja lind në qendrën shëndetësore

ELBASAN - Një 25-vjeçare, e cila është bllokuar nga dëborë brenda shtëpisë, ka lindur dje fëmijën e saj të dytë në fshatin Labinot-Katund, falë ndihmës së stafit të Qendrës Shëndetësore të këtij fshati. Bëhet fjalë për Luljeta Cocën, e cila është ndihmuar nga një infermiere e kësaj qendre shëndetësore, e cila është transportuar në zonën e thellë malore nga një ambulancë që ka qarkulluar me zinxhirë. Mësohet se nëna e re ka lindur pa ndërlikime dhe është transportuar më pas në maternitetin e Elbasanit, ku aktualisht po merr trajtimin e nevojshëm. Sipas burimeve nga Elbasani, rruga kishte vështirësi dhe rrezik nga akulli, por pavarësisht situatës, mësohet se gruaja dhe fëmija ja shpëtojnë shëndet të mirë.



SHKODËR

Reshjet e dëborës dhe moti me erë të fortë kanë shkaktuar probleme të shumta në vend. Në qytetin e Shkodrës është shënuar një incident, teksa raportohet se një pemë ka rënë sipër një kabine elektrike, duke dëmtuar transformatorin. Mësohet se ngjarja ka ndodhur në lagjen "Stom Golem" të këtij qyteti. Menjëherë ekipi i OSHEE-së ka dalë në terren dhe po punon për riparimin e defektit në qytetin verior.



DARDHË/KORÇË

Rruga që të çon për në Dardhë të Korçës është bllokuar për shkak e shkarjes së masivit të borës dhe për pasojë është ndërprerë lëvizja e automjeteve në aksin që të çon drejt zonës turistike. Mësohet se shkarja më masive ka ndodhur tek "Muri i Musit" dhe vendin e quajtur "Gryka", ndërkohë po punohet me mjete borëpastruese për të hapur rrugën e fshatit turistik. Në këtë zonë dëborë arrin në 60 cm.



AKSIDENTI/ LUSHNJË

Një aksidenti i rëndë ka ndodhur mbrëmë në Lushnjë. Si pasojë një person ka mbetur i vdekur, ndërsa dy të tjerë janë plagosur. Nga raportimet e para thuhet se mjeti tip "BMW X5" me targa AA858CV humbi kontrollin duke dalë nga rruga. Të plagosur janë drejtuesi i mjetit dhe një pasagjere. Shkak i aksidentit dyshohet të ketë qenë lagështia në rrugë. Policia po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Në rajonin qendror Tiranë: Gjatë natës dhe tani ka reshje shiu dhe bore. Në akset e Dajtit po punohet nga kontraktori për pastrimin dhe trajtimin me kripë. Segmenti Qafë Priske-Qafë Mollë-Shëngjergj, Trau Dajt-Teleferik qarkullohet me zinxhirë. Reshje të dobëta ka pasur në Gjinan dhe Steblevë. Po punohet intensivisht për pastrimin e akseve. Deri tani nuk ka probleme. Në Librazhd-Qafë Thanë ka pasur reshje me intensitet. Qarkullimi rekomandohet me zinxhirë. Në rajonin jugor Gjirokastrë: Në Qarqet Korçë dhe Gjirokastrë ka reshje me intensitet të

lartë. Në akset e Korçës trashësia e borës shkon rreth 20 cm. Në akset e Dardhës, Voskopojës, Korçë-Qafë Qarri-Ersekë, Liqenas-Dogana Goricë, qarkullohen me zinxhirë. Aksi kryesor Qafë Thanë-Pogradec-Korçë-Kapshiticë qarkullohet me zinxhirë. Edhe segmentet Tepelë-Dorëz-Qafë Dushk dhe Sevaster-Kalivac, Përmet-Çarshovë, Ura e Leklit-Këlcyrë, Jorgucat-Muzinë-Syri i Kaltër, Gjirokastrë-Tepelenë dhe Gjirokastrë-Kakavijë qarkullohet vetëm me zinxhirë. Rruga Dukat-Llogara-Sarandë është e hapur dhe qarkullohet pa zinxhirë.

“Zëri i Amerikës”: Institucionet shqiptare në shërbim të firmës që fitoi 30 milionë euro me falsifikim

Komisioni i qeverisë favorizoi "DH Albania"

Firma "fantazmë" aplikoi për licencë pa u regjistruar ende në QKR

Armand Mero

Në Shqipëri zbulohen detaje të tjera lidhur me kompaninë 'DH Albania', e cila fitoi garën për ndërtimin e një pjese të Unazës së Re në Tiranë, duke përdorur dokumente të falsifikuara të një kompanie amerikane Dunwel Haberman. 'Zëri i Amerikës' ka siguruar informacione që dëshmojnë se administrata shqiptare ka ndihmuar kompaninë 'DH Albania' për marrjen e licencës së ndërtimit në zbatim, duke nisur procedurat, përpara se vetë kompania të regjistrohej zyrtarisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Në fund të dhjetorit, duke folur për rastin e kompanisë 'DH Albania',

REAGIMI

Sekretariati Teknik i Komisionit të Lincencimit tha dje se nga ky komision është zbatuar procedura ligjore dhe mbledhja e datës 30 korrik 2018 ka marrë në shqyrtim aplikimin e shoqërisë "DH Albania" për njësimin e licencës së huaj vetëm pasi shoqëria ka plotësuar të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar, përfshirë edhe dokumentin e pretenduar nga "Zëri i Amerikës", aktin e regjistrimit në QKB.



HETIMET E PROKURORISE

Prokuroria, e cila po heton si për krimin e falsifikimit ashtu dhe për atë të shpërdorimit të detyrës, nga ana e institucioneve të përfshira, nuk ka mundur ende të thërrasë Avdjol Dobin, i cili, të paktën zyrtarisht, nuk rezultoi të ketë dalë nga Shqipëria.

INVESTIGIMI NE "NEWS 24"

Gazetari Ylli Rakipi dhe emisioni "Të Paekspozuarit" në "News 24", ishin të parët që zbuluan në fillim të dhjetorit, se kompania 'DH Albania' kishte fituar 30 milionë euro në dy tenderë përmes një serie dokumentesh të falsifikuara.

kryeministri Rama deklaroi se "kompani që hyjnë me letra të falsifikuara nëpër tenderë ka në të gjithë botën. Një qeveri, një ministri, një ministër nuk gjykohen nga fakti nëse hyn apo nuk hyn një kompani me letra të falsifikuara. Gjykohen nga mënyra sesi reagojnë në momentin kur fakti konstatohet... Për sa i përket rastit në fjalë, ku është korrupsioni që ka ndodhur, që të jem unë i qartë? Si?" u shpreh ai.

Që prej momentit, kur emisioni "Të Paekspozuarit" në News 24, zbuloi në fillim të dhjetorit, se kompania DH Albania kishte fituar 30 milionë euro në dy tenderë përmes një serie dokumentesh të falsifikuara, në disa dalje publike kryeministri Edi Rama i mëshoi faktit se bëhej fjalë, sipas tij, thjesht për një mashtrim nga ana e kompanisë. Tenderët e fituar u anuluan dhe për këtë çështje ka nisur një hetim i prokurorisë.

Por informacionet e siguruar nga Zëri i Amerikës, dëshmojnë se institucionet shqiptare duket se janë vënë në shërbim të plotë të kompanisë, madje edhe në shkelje të rregullave dhe kërkesave ligjore.

Sipas një përgjigjeje zyrtare, që Ministria e Infrastrukturës i ktheu kërkesës për informacion nga 'Zëri i Amerikës', rezultoi se "Shoqëria 'DH-ALBANIA', degë e shoqërisë së huaj, me kërkesën e saj të datës 13.07.2018, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, ka aplikuar për njësimin e licencës së huaj, në fush-

ën e zbatimit në ndërtim", thuhet në shpjegimin dhënë për 'Zërin e Amerikës'.

Referuar faqes zyrtare të ministrisë së Infrastrukturës, në seksionin për formularët e aplikimit për ekuivalentimin e licencës së shoqërive të huaja, (h t t p : / / infrastruktura.gov.al/formular%20aplikimi-3/) në kërkesat e renditura për aplikim, pika b) parashikon dhe paraqitet në "esktraktit historik, apo ekstraktit për të dhënat e subjektit të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me të cilën dëshmohet ndër të tjera, lidhja e shoqërisë së krijuar, që kërkon të licencohet, me atë të vendit të origjinës që disponon licencë profesionale, vepërimaria dhe statuti aktiv i shoqërisë".

Por më datë 13 korrik, kur është bërë aplikimi, shoqëria 'DH Albania' ishte ende inekzistente. Referuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, data e saj e regjistrimit figuron 18 korriku 2018, me përfaqësues një 26 vjeçar të panjohur Avdjol Dobin. Është e pakuqteshme se si Sekretariati i Komisionit të Licencave, ka nisur procedurat mbi një entitet, që deri në atë moment nuk ekzistonte. Sikundër është e paqartë, se çfarë dokumentacioni, kompania ka paraqitur për t'u identifikuar si 'DH Albania', duke qenë se e ka patur të pamundur të dorëzojë një ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Komisioni i Licencave, i cili drejtohet nga Gerta Lubonja, e emëruar me vendim të Këshillit të Minis-

trave, ka në përbërjen e tij dhe tre drejtorë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës. Bazuar në afatet kohore të ushtrimit të aktivitetit të tij, të publikuara deri pak ditë më parë në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës (h t t p : / / infrastruktura.gov.al/ep-content/uploads/2018/10/aAFATE.pdf) "dokumentacioni i shoqëruar me material përmbledhës të hartuar nga sekretariati teknik, i vihet në dispozicion anëtarëve të Komisionit 3 ditë pune përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes".

Licenca për 'DH Albania' është dhënë në mbledhjen e datës 30 korrik, e cila ka qenë ditë e hënë. Për pasojë, dokumentacioni për të, do të duhej t'i dorëzohej Komisionit, të paktën më 25 korrik. Por sipas përgjigjes zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës, 'DH Albania', i ka plotësuar dokumentet vetëm më 27 korrik.

Shkeljet në favor të 'DH Albania', bëjnë të mendosh se Komisioni e ka patur të qartë se nuk po ndihmonet thjesht të riun Avdjol Dobin, por njerëzit real që qëndrojnë pas kësaj kompanie. Një seri të dhënash ngrënë dyshime të forta që të çojnë tek biznesmeni i njohur Bashkim Ulaj. Që nga lidhjet familjare mes të dyve, të fakti se punonjës së kompanisë Gener 2, të zotit Ulaj janë angazhuar në plotësimin e dokumentacionit të 'DH Albania'-s e deri te pagesa që GENER 2, siç dëshmoi një investigim i BIRN-it, ka bërë për llogari të kësaj kompanie.

INVITATION FOR BIDS (IFB)

Date: 09.01.2019
Contract Identification N°: Ref: AL-8521/CW/NCB/2.1.03
World Bank Loan/Credit N°: 8521-AL
World Bank Loan/Credit Name: Citizen Centric Service Delivery Project

- This Invitation for Bids follows the General Procurement Notice for this Project that appeared in *Client Connection online*, on August 28, 2015.
- The Government of Albania has received¹ a loan from the International Bank for Reconstruction and Development² towards the cost of *Citizen Centric Service Delivery Project* and intends to apply part of the funds to cover eligible payments under the Contract for **"Refurbishing and furniture of the Integrated Citizen Service Center of Kombinat"**, Ref: AL-8521/CW/NCB/2.01.03. Bidding is open to all bidders from eligible source countries as defined in the Guidelines: *Procurement under IBRD Loans and IDA Credits*.

3. The Agency for Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA) invites sealed bids from eligible bidders for Refurbishing and furniture of the Integrated Citizen Service Center of Kombinat. The main objective is the fulfillment of all required spaces, while achieving functional performance, fulfilling according norms and standards, finishing treatment, and required humidity, flow of light, ventilation and air-conditioning. The detailed project consists in the refurbishment/reconstruction of the selected premise and its adaptation into a center for the provision of public services through the establishment and management of receiving counters for the citizens (front office) and integrated public service centers (one stop shop).

3. A complete set of Bidding Documents in English may be obtained at no cost by interested bidders on the submission of a written application or e-mail to the address given below. Further the Bidding Documents may also be downloaded from any of the following websites: www.adisa.gov.al

Project Management Unit

Bldv: Zhan d'Ark,
Ish shtepia e oficerave, Kati V-te
Tirana, Albania
e-mail: roland.larashi@adisa.gov.al;
info@adisa.gov.al
and fiorentina.jorgji@adisa.gov.al

- Bids shall be valid for a period of 60 days after Bid closing and must be accompanied by security of 5,000 EUR or an equivalent amount and shall be delivered

Project Management Unit

Bldv: Zhan d'Ark,
Ish shtepia e oficerave,
Kati V-te, Tirana, Albania
Tel: +355666191381

on or before 06 February 2019, at 12.00, local time at which time they will be opened in the presence of the bidders who wish to attend.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



DOSSIER

Emisioni "Opinion" trajton vdekjen e ish-kryeministrit të vendit në 18 dhjetor të vitit 1981

U vra apo u vetëvra Mehmet Shehu? Ç'thonë i biri dhe personat e afërt

Gazetari Blendi Fevziu ka bërë një emision kushtuar jetës dhe karrierës së ish-kryeministrit Mehmet Shehu, ku mes të tjerash trajtohet nata mes 17 dhe 18 dhjetorit të vitit 1981 dhe dëshmitë e personazheve që u gjenden pranë tij mëngjesin e 18 dhjetorit. Përmes emisionit të realizuar më 15.12.2005, Fevziu vë përballë dëshmi të disa personave, të cilët mendojnë se ishte vrasje dhe disa të tjerëve, të cilët mendojnë se ishte vetëvrasje. "Mëngjesin e 18 dhjetorit, si zakonisht do të vazhdonte mbledhja e Byrosë Politike. Unë nxora makinën dhe po prisja të shoqëroja Mehmetin. Isha poshtë shtëpisë... kur dëgjoj një ulërimë. Na njoftojnë që bashkë me doktorin të ngjiteshim lart. Gjej në korridor Ladin, i cili më thotë të shikoj Mehmetin. Futem në dhomë dhe e shikoj të zverdhur, me sytë mbyllur, gojën të mbyllur dhe mendova se i kishte rënë të fikët. Ngrija batanijen që t'i matja pulsën dhe dora e tij ishte gjysmë e ngrirë. Tek xhepi i këmbës shikoj një nollë të zezë dhe mbi batanije, tek këmbët e tij ishte pistoletë. "Mos - thamë - paska vrasë veten". Në dhomë shikoj hijen e një dore, ishte Ladi, i cili kishte marrë në dorë letërën. Shkoi tek telefoni dhe marr Ramizin, i them se Mehmeti kishte vrasë veten dhe ai më përgjigjet: "Joo, ore". I thashë që ai ka lënë edhe një letër. Kur dëgjoj këtë, ai u tërbua fare dhe më tha: "Të mos e lexojë njeri letërën, do ta hajë e zeza, do t'i bëjë këtë e atë". Ka ardhur Ramizi me Kadriun të shtëpia e Mehmetit për të marrë letërën. Ramizi qëndroi poshtë dhe Kadriu u ngjiti në katin e dytë. Kadriu pa Mehmetin dhe u drodhi e mbushi sytë me lot. Aq e rëndësishme ka qenë ajo letër, sa kushdo që e preku me dorë, gjeti vdekjen", tha Ali Çenaj.

Në të vërtetë letra u bë publike në vitin 2002, 21 vjet pas vdekjes së Mehmet Shehut. Në faqen e parë shkruhej: "Ta hapë personalisht shoku Enver e askush tjetër".

Nuk dihet se sa autentike ishte letra, pasi mënyra se si është shkruar nuk të krijon bindjen që ai po shkon drejt vdekjes, pasi në të thuhet: Rroftë komunizmi dhe poshtë reaksioni!

Por sipas presidentit Ramiz Alia, Mehmet Shehu kishte vrasë veten dhe historia komplikohet kot. "Mehmeti ishte njeri me një karakter tepër të vështirë dhe nuk duronte dot të kritikohet dhe të jetonte me një barrë në kurriz pas asaj që i ndodhi. Ne të tërë u habitëm që ai vrau veten", tha Alia.

Vetëm rreth 3 orë pasi u gjeti vdekur në shtratin e tij, Mehmet Shehu nisi të etiketohet si armik i partisë, ndërkohë që Byroja nuk kishte pasur kohë të nxirrte një konkluzion.


4 KRYEMINISTRAT E VRARË

- Esat Toptani, i cili qeverisi nga shtatori i 1914 deri në janar 1916 dhe u vra në Paris nga Avni Rustemi.
- Qazim Koculi, i cili ka drejtuar vendin për 24 orë, nga mëngjesi deri në mbrëmje të datës 6 dhjetor 1921 dhe që u vra gjatë luftës nga gjermanët.
- Hasan Prishtina, i cili ka qenë kryeministër për 7 ditë, nga 7 dhjetori i 1921 deri më 12 dhjetor 1921.
- Xhaferri Ypi qeverisi nga dhjetori i vitit 1921 deri në dhjetor të vitit 1922 dhe është vrasë gjatë luftës italo-greke.

Mëngjesin e 18 dhjetorit, Istref Myftari, i cili ishte edhe shefi i Laboratorit të Kriminalistikës në Ministrinë e Rendit, merr një njoftim të rëndësishëm.

"Sa hyra në zyrë, më merr në telefon drejtori i Hetuesisë dhe më thotë që ka ndodhur një ngjarje e rëndë. Në ngjarjet e rënda unë shkoja gjithmonë dhe merrja me vete edhe një ekspert, por atë ditë më thanë të shikoj vetëm. Më bëri përshtypje se në shtëpinë e Mehmetit na prishte z.ministri i Brendshëm, i cili na tha se Mehmet Shehu kishte vdekur. Ishte lajm i papritur dhe i rëndë. Mehmet Shehu ishte kryeministër i vendit, por detyra është detyrë dhe duhet bërë. Shkuam në dhomë dhe nisëm këqyrjen e vendit të ngjarjes. Përveç grupit hetimor, kanë qenë edhe dy persona të tjerë, një prej tyre ishte edhe mjeku i Mehmetit, Ali Çenaj nuk e mbaj mend. Skena e ngjarjes ishte normale. Në vetëvrasje ka një parapërgatitje dhe personi do që ta lërë në rregull vendin. Në përfundim të të gjithë këqyrjes, unë kam arritur në përfundim se ishte vetëvrasje", tha Myftari. Sipas procesverbalit të mbajtur nga hetuesi i çështjes, Koço Josifi, një nga dëshmitarët ka qenë Ali Çena, i cili në intervistën e tij për "Opinion" në vitin 2005, ngre dyshime lidhur me procesin hetimor dhe "zhdukjen" e provave. "Grupi i ekspertëve ka ardhur pas gati 2 orësh dhe filluan të bëjnë kontrollin e dhomës. Te komodina ishte një gotë me një lëng të verdhë, sepse ai zakonisht pinte kamomil ose lule bliri, por mënyra se si u zhduk ajo gotë, mua më lë të dyshoj shumë. Ne shkuam te zyra e Mehmetit dhe kur u kthëm, gota ishte zhdukur. Më pas e gjetëm të larë dhe të kthyer përmbys në lavaman. Kjo më lë të dyshoj se aty mund t'i kenë futur ilaç gjumi dhe mund ta kenë asgjësuar", shton Çenaj. Televizioni i vetëm në Shqipëri në atë kohë jep lajmin për vdekjen e ish-kryeministrit në mënyrë shumë të vakët. Mediat botërore transmetojnë lajmin, duke futur në thonjëja vetëvrasjen, ndërkohë që një pjesë e tyre shkruanin se Mehmet She-

hu ishte eliminuar. Bashkim Shehu, djali i ish-kryeministrit ishte një nga personat që ndodhej në shtëpi natën që ndodhi ngjarja. Në intervistën e tij, ai deklaronte se dikur ka pasur dyshime, por në vitet '90 është bindur se babai i tij ka vrasë veten. "Në një farë periudhe kam pasur dyshime, por tashmë jam i bindur që ka vrasë veten dhe e kam thënë edhe publikisht. Dhe që në atë kohë nuk ka dalë asnjë fakt për ta kundërshtuar, përkundrazi, kanë dalë fakte që e kanë konfirmuar", deklaroi Bashkim Shehu. Ndërkohë, një tjetër dëshmi që kundërshton atë të Bashkim Shehut është edhe ajo e



Mehmet Shehu

ishte shumë e ashpër", thotë në intervistë Liljana Hoxha.

Ismael Kadare po ashtu ka hedhur një version të tjetin të ngjarjes në romanin "Pasardhësi". Një roman që ka në thelb atë që ndodhi në shtëpinë e ish-kryeministrit shqiptar, në dhjetorin e vitit 1981. "Normalisht, sipas logjikës së tiranisë, ai duhej të eliminohet për arsye që nuk janë kurrë në radhë të parë politike, por njerëzore. Mehmet Shehu kishte disa dobësi të mëdha në jetën e tij, që acarorin çdo diktator që mund të ishte mbi të. Ai kishte disa gjëra që një tiran nuk i fal kurrë, kishte aureolë. Kishte një aureolë me autoritet

te udhëheqës i luftës, por nuk mbahej mend si luftëtar: ishte organizues i gjithçkaje, por fjala organizim nuk i thoshte asgjë. Me një fjalë, Mehmet Shehu kishte ato që nuk duhej të kishte dhe këto përbënin objektivitetin e rënies së tij. Pika e ujit që kapërceu gotën ishte shtëpia e tij, e cila për fatin e tij të keq doli që ishte më e bukur se ajo e Enver Hoxhës, ose mesa duket, ishte me të vërtetë. Historia tregon se edhe këto gjëra kaq banale, ndonjëherë mbushin kupën dhe fillon derdhet gjaku pastaj", tha Kadare.

Kujtim Shehu, nipi i Mehmet Shehut kujton varrimin e xhaxhait të tij, si një nga varrimet më të trishtuara. Një njeri që ndoshta duhet të kishte pritur një ceremoni zyrtare, befas gjendet i shoqëruar për në banesën e tij të fundit nga 6 persona dhe nga një makinë e vjetër funeralesh. "Në varrimin e Mehmetit kemi qenë 6 persona. Ka qenë Bashkimi me të shoqen dhe vjehërin i tij, Vladimiri, xhaxhai i vogël Nexhipi dhe unë. Kur kemi shkuar në varrezë ka qenë një grup, ndoshta zyrtarësh, të cilët qëndruan në distancë. Vladimiri mbajti një fjalë të shkurtër dhe kështoi Mehmetin u varros me 6 veta", tha Kujtim Shehu. Në fakt, në një mënyrë ose në një tjetër, Mehmet Shehu ishte viktimë e një sistemi që ai ngrihi vetë. Dhe ai vetë kishte qenë më parë kontribues i eliminimit të shumë prej miqve, shokëve apo bashkëpunëtorëve të tij. Mbyllja e historisë së Mehmet Shehut është akoma më e dhunshme, ndryshe nga para-ardhësit e tij. Eshtarët e tij që ishin varrosur në Sharrë, u hoqën në heshtje pak ditë pas varrimit nga oficerët e Sigurimit, për t'u varrosur në një vend tjetër në periferi të Tiranës, në një nga zonat pranë Ndroqit. Por rreth vitit '87-'88 u rihodën nga varri i dytë dhe u futën buzë një lumi, ku rastësisht një bari arriti t'i shihte dhe që dëshmoi tek familja e Mehmet Shehut. Ai u rivarros edhe një herë në maj të vitit 2001. Historia i tij do të vijojë të mbetet mister dhe të nxisë fantazinë e mediave dhe njerëzve.



Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu

nuses së djalit të Enver Hoxhës, Liljana Hoxha. "Unë mbështes linjën jo thjesht nga dyshimet që janë hedhur gjithë këto kohë, që kemi të bëjmë me një vrasje. Përveçse gjykoj që kemi të bëjmë me një krim politik, qoftë edhe vetëvrasje nën presion, apo vrasje e mirëfilltë, çdo moment që ka kaluar kam analizuar dhe lexuar dhe them që kemi të bëjmë me një vrasje të tipit sa më urgjent, për vetë faktin se atë natë, mbledhja e Byrosë

botëror, aureolën e Spanjës, kishite aureolën e luftës më shumë se gjithë të tjerët. Komandanti i Brigadës së Parë, që ishte bërë thuasje legjendare dhe aureolën e çliruesit të Tiranës. Kurse Enver Hoxha kishte një aureolë më të madhe, por nuk mbahej mend, nuk ishte spektakolare. Aureolat e Hoxhës nuk ishin nga ato që kujtesa popullore i kujton. Ishte themelues i partisë dhe kjo dilte në mënyrë të tipit sa më urgjent, për vetë faktin se atë natë, mbledhja e Byrosë

Alban Skënderaj dhe Miriam Cani, shumë shpejt me diçka interesante

Dashuri dhe biznes, ja çiftet që kanë investuar së bashku

Detajet e sukseseve të VIP-ave

Egla Xhemali

Tashmë nuk janë të paktë ato personazhe të njohur të botës së artit dhe televizionit, të cilët i kanë hyrë fuqishëm botës së biznesit. Në të shumtën e rasteve nuk ka shumë lidhje me profesionin që ata bëjnë, por që duhet gjithsesi një shpirt artistik për ta krijuar dhe zhvilluar. Listën e këtyre personazheve e kryesojnë Ami dhe Ermali që kanë biznesin e organizimit të eventeve, kryesisht martesave, për të cilat kujdesen që nga fustani i nuses e deri te DJ. Në emrin e Amit është gjithashtu dhe biznesi i fitnesit, me saktë i "Body code", aq shumë në modë vitet e fundit në Tiranë.

Më tej kujtojmë Jonida Maliqin që ka zgjedhur të merret me një dyqan veshjesh, çantash dhe këpucësh firmato, duke i shkuar kështu nga pasionit të saj të madh për modën. Zajmina Vasjari dhe Rozana Radë kanë hapur atelie veshjesh, të cilat mund të blihen ose të jepen me qira. Rezarta Shkurta ka një biznes me të cilin rezultoi



shumë e suksesshme. Ajo ka hapur "Hera Company", ku bën sete fotosh për bebe dhe mami. Së fundi ka hapur edhe "Hera Shop", me veshje për fëmijë dhe për mamatë.

Nuk ka si të mungojë edhe Alketa Vejsiu, e cila pas agjencisë së eventeve "Class by Alketa", ka zgjeruar aktivitetin e saj me disa filiale, të cilat kanë lidhje me biznesin kryesor, siç janë fotogra-

fia, studio e 'make-up'-it etj. Botës së biznesit i është futur dhe aktori i humorit Besart Kallaku, i cili së bashku me Xhensilën kanë një restorant në Bllok. Është bërë trend sidomos hapja



e dyqaneve që kanë fustane nuseshe dhe një të tillë e kanë edhe Andra me Sinan Hoxhën. Emrave të personazheve të njohur që kanë biznes shumë shpejt do u bashkohen dhe Miriami e


Albani. Ata kanë preferuar që ta mbajnë sekret çdo detaj që ka lidhje me të. Deri në prezantimin e këtij biznesi që po përflitet se do jetë mjaft interesant do na duhet të presim.



Almeda Albazi bën ndryshimin drastik në pamje

Bukuroshja e njohur Almeda Abazi, shumë shpejt do të bëhet nënë për herë të parë. Ajo është në muajin e gjashtë të pritjes së ëmbël dhe vetëm disa javë më parë publikoi për herë të parë barkun e rrumbullakosur.

Ajo ka ndarë me ndjekësit në 'Instastory' disa foto që me siguri i kanë lënë të gjithë gojëhapur. Ajo shfaqet në parukeri me një look të ri, flokë biond me baluke dhe të prerë deri mbi supet. Pas disa pozave me pamjen e re, Almeda i ka qetësuar ndjekësit duke lënë të kuptohet se ishte thjesht një paruke. "Mos u shqetësoni", shkruan Almeda në foton ku shfaqet sërisht me flokët e saj të gjatë e të zinj.





Inxorën foto nga përditshmëria, reagimi i Encës do ju lërë pa fjalë

Encë është një nga këngëtares më të njohura e më të komentuar në rrjetet sociale. Para pak ditësh ajo ka bërë një postim paksa të papritur drejtuar njerëzve që janë marrë me të së fundmi pasi u publikua një foto e saj në një banjë.

"Mësim për ju dështakë: Jam kaç e çmuar dhe e rëndësishme sa ju merrni fotot e mbeturinave të mia. Jam Zoti juaj. Dhe sa për krahasimet... edhe në ditët e mia më të këqija ndihem si krijesa më e bukur në botë sepse ashtu jam... Dhe kështu duhet të ndihen të gjithë (përveç ju urreyve, juve që keni Zot m**in tim" - shkroi Encë.

E siç duket asaj nuk i ka dalë e keqja dhe mbrëmjen e djeshme ajo publikoi një video teksa filmonte veten nga pas e si një përgjigje për fansat e saj ka shkruajtur:

"Perspektiva e kritikuesve, gjithmonë pas meje, gjithmonë pas të pasmeve të mijta".



"Mami, babi dhe unë Ilapushi", Bes Kallaku bëhet nostalgjik

Ai është kthyer shumë pas në kohë dhe ka publikuar në 'Instagramin' e tij një foto ku shfaqet me prindërit. Në foton bardh e zi, Besi duket një vogëlush tejet i ëmbël. Por siç e ka zakon, aktori edhe në këtë foto ka zgjedhur përshkrim epik.

"Babi, mami edhe unë Ilapushi...qysh atëherë kam pas pa shtrembër", shkruan Kallaku. Kujtojmë që Besi u bë baba për herë të parë në korrik të vitit që lamë pas. Xhensila solli në jetë një vajzë, të cilën e pagëzuan me emrin e veçantë, Ajka.



Nuk do ta njihni! Arbana Osmani më e ëmbël se kurrë

Moderatorja e njohur Arbana Osmani ka befasuar të gjithë me ndryshimin e saj më të fundit të pamjes. Në një foto të publikuar krahas moderatorës Xhemi Shehu, mikeshës së saj më të ngushtë, Arbana duket me flokët ngjyrë të errët. Për një kohë të gjatë e kemi parë në ekran me nuancat e biondes, por tashmë duket se me Vitin e Ri është koha e ndryshimeve dhe Arbana është kthyer brune e duhet të themi që duket mjaft e ëmbël. Arbana shfaqet duke buzëqeshur ndërkohë që i jep makinës, teksa flokët i ka hedhur pas krahëve.



Analisti gjerman: Ndarja e Kosovës do të kishte pasoja fatale

SHBA: Shkëmbimi i territoreve Kosovë-Serbi s'është opsion

Ish-presidenti serb, Tadiç paralajmëron konflikt të ri



Taksa ndaj Serbisë, Hahn: Presim përgjigje nga Kosova

Lidhur me dialogun Kosovë-Serbi, analisti gjerman, Bodo Weber thotë se do të befasohet nëse gjatë vitit 2019 do të arrihej një marrëveshje përfundimtare gjithëpërfshirëse, ligjërshite e detyrueshme në mes tyre. Arsyja për këtë, sipas analistit gjerman, është se të gjitha palët në negociatë, para së gjithash Serbia, të inkurajuar nga përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini dhe ekipi i saj, më pas edhe të mbështetur nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, shpenzuan një vit e gjysmë në fazën e re në dialog për të nxitur idenë e demarkacionit dhe korrigjimit të kufirit, respektivisht shkëmbimit të territorit ose ndarjes së Kosovës. "Kjo filloi si një rrotullim politik fillestar nga Beogradi, dhe më duket se ka eskaluar në një përpjekje për të shfrytëzuar një dozë të krizës dhe dobësisë politike të Perëndimit, të inkurajuar nga një pjesë e aktorëve nga BE dhe SHBA. Por doli se Perëndimi, mbi të gjitha BE-ja, nuk ishte aq i dobët sa shpresonin disa", tha Weber për gazetën serbe "Blic".



Ish-Presidenti i Serbisë, Boris Tadiç

Analisti gjerman thotë se kjo është arsyeja pse negociatat në vitin 2018 përfunduan krejtësisht në bllokadë, derisa përpjekja e Beogradit për ta shtyrë dialogun jashtë kornizës që është përcaktuar në fillim, të pranuar nga të gjitha palët negociuese - njohjen e realitetit të humbjes së Kosovës nga Serbia dhe duke u fokusuar në normalizimin gjithëpërfshirës mes dy vendeve dhe për të siguruar jetën normale të serbëve që jetojnë në shtetin e Kosovës, u shpërblye me perspektivën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe mbështetjen në fuqizimin ekonomik të Serbisë - pësoi dështim me refuzimin e idesë së etno-territorialitetit nga Gjermania dhe shumica e shteteve anëtare të BE-së, dhe me rezistencën e partive parlamentare shqiptare. "Dyshoj se të gjithë negociatorët kanë hequr dorë nga ideja për

ndarjen dhe shkëmbimin e territorit, por ajo nuk do të kalojë. Por, në qoftë se do të kalonte kjo ide, nuk do të shpallte stabilitet dhe do të ishte fatale për jetën e serbëve të Kosovës në jug dhe në veri të lumit Ibër. Rruga deri të marrëveshja përfundimtare çon nëpërmjet një 'resetimi' të plotë të negociatave, kthimit në kornizën fillestare të dialogut, kthimit në realitetin politik, e jo përmes një fushate gjithëpërfshirëse për të mbështetur shtetin e Kosovës nga autoritetet e Beogradit", tha Weber. "Fokusi duhet të jetë në atë që do të garantonte se marrëveshja vërtetë do të jetë historike - normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, si dhe marrëdhëniet bilaterale mes dy shteteve demokratike, për

jetën e përditshme, problemet e përditshme të serbëve të Kosovës, të sigurisë dhe socioekonomike", tha ai. Nga ana tjetër, analisti amerikan dhe eksperti i çështjeve të Ballkanit, Daniel Serwer, thotë se është e mundur të zgjidhet çështja mes Kosovës dhe Serbisë, por gjithçka varet nga vullneti politik i të dy palëve. Ndërsa thotë se duket që korrigjimi i kufijve nuk është më në tavolinë si opsion. Ai thotë se vullneti politik në masë të madhe varet nga presidentët e dy shteteve. "Është e pamundur të parashikohet nëse do të vendosin ta zgjidhin këtë çështje brenda këtij viti. Duket se Prishtina është më e padurueshëm se Beogradi për ta bërë këtë, por unë shpresoj se kjo do të ndryshojë, pas po bëhet e qartë se

ndonjë politikan, diplomat ose profesor karrierën e të cilit mund ta shkatërronjë", tha Serwer. Ndërsa ish-presidenti i Serbisë, Boris Tadiç, është shprehur se nëse problemi i Kosovës do të zgjidhej në atë mënyrë që njëra palë do të fitonte gjithçka dhe pala tjetër do të humbte gjithçka, me shumë mundësi do të lindë një konflikt i ri. "Të gjitha zgjidhjet tjera na dërguan në një situatë ku një palë merr gjithçka dhe një tjetër humb gjithçka, gjë që mund të dërgojë në një shpërthim të një konflikti të ri në të ardhmen. Është e vështirë për të llogaritur se cili opsion është më i keq. Absolutisht nuk pajtohem me ata që mendojnë që duhet të vazhdohet konflikti i ngrirë, e as me ata që besojnë që duhet hequr dorë nga Kosova sa më parë të jetë e mundur, pasi asnjë prej tyre nuk i kuptojnë implikimet e qasjeve të tilla", është shprehur Tadiç. Ai ka shtuar se konflikti i ngrirë nuk do të mund të vazhdojë edhe për një kohë të gjatë për shkak të rritjes ekonomike dhe demografike të Serbisë. Ai ka thënë se partia e Aleksandër Vuçitit ka qenë një nga partitë e cila e ka sjellë këtë gjendje në raport me Kosovën, pasi sipas tij që nga vitet e 90-ta kanë bërë vepime të cilat e kanë ngushtuar hapësirën vepruese për zgjidhjen e problemit të Republikës së Kosovës. Tadiç thotë se për të mbuluar këto dështime, tashmë ata akuzojnë qeverisjen paraprake në Serbi.

Johannes Hahn, Komisioneri Evropian për Zgjerim, shpreston që gjatë këtyre ditëve përgjigjet lidhur me takсэн e vendosur ndaj mallrave që importohen nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Sipas medieve serbe, Komisioneri Hahn është shprehur në Bruksel se për barrierat tregtare do të bisedohet në një format të veçantë, ndërsa për takсэн duhet të gjendet një zgjidhje, shkruan telegraf. "Shpresoj në një përgjigje nga Kosova gjatë këtyre ditëve. Për këtë nisen nga fakti se gjatë këtij viti do të hapen kapituj të rinj me Serbinë dhe Malin e Zi", ka thënë Hahn. Kërkesën për heqje të takсэн e ka përsëritur edhe përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, pas takimit që ka pasur të martën me delegacionin kosovar për dialog me Serbinë, të kryesuar nga Fatmir Limaj e Shpend Ahmeti. Kërkesa e tyre është kundërshtuar hapur nga kryeministri Haradinaj, i cili është shprehur se taksa nuk do të hiqet derisa Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës.

Dje faza finale, Kuvendi në Shkup votoi ndryshimet kushtetuese

VMRO-DPMNE s'merr pjesë, Zaev merr mbështetjen e shqiptarëve pas takimeve me opozitën

Kuvendi u prit të votonte ditën e djeshme, fazën finale për ndryshimin e Kushtetutës, sipas marrëveshjes së Prespës me Greqinë për çështjen e emrit. Që të kalojë teksti i amendamenteve kushtetuese të propozuar nga qeveria, duhet të mbështeten nga së paku dy të tretat e deputetëve në Kuvend ose 80 deputetë të votojnë "pro", informon INA. Kryeministri Zoran Zaev është shprehur optimist se do të sigurohen 80 vota në Kuvend në votimin final për zbatimin e marrëveshjes së Prespës, e cila parasheh ndryshime kushtetuese në Maqedoni. Në kuadër të ndryshimeve do të përfshihen edhe amendamentet e partive opozitare shqiptare si ASH-së dhe Lëvizjes BESA", - ka thënë Zaev.

ZORAN ZAEV
"Do të sigurohen 80 vota në Kuvend në votimin final për zbatimin e marrëveshjes së Prespës, e cila parasheh ndryshime kushtetuese në Maqedoni. Në kuadër të ndryshimeve do të përfshihen edhe amendamentet e partive opozitare shqiptare si ASH-së dhe Lëvizjes BESA", - ka thënë Zaev.

hen edhe amendamentet e partive opozitare shqiptare si ASH-së dhe Lëvizjes BESA. VMRO-DPMNE ka njoftuar se nuk do të merr pjesë në procesin e ndryshimeve kushtetuese. Nënkr-

etari i kësaj partie, Aleksandar Nikolovski tha se do të përjashtohen ata deputetët nga radhët e tyre, nëse do të votojnë për ndryshimet kushtetuese. Seanca finale sipas rregullores së Kuvendit

nuk mund të zgjasë më shumë se dhjetë ditë. Pasi të përfundojë procesi i ndryshimeve kushtetuese përfundon procedura në Shkup, ndërsa më pas "topi hidhet" tek Greqia, e cila, gjithashtu, me shumicë votash të deputetëve duhet të ratifikojë marrëveshjen. Mbetet ende e paqartë nëse opozita shqiptare do t'i mbështesë ndryshimet, por Kryeministri Zoran Zaev, pas takimeve me kërret e Lëvizjes Besa dhe Aleancës për Shqiptarët, shprehet besimplotë për arrijtjen e shumicës absolute.



Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev

VMRO-DPMNE ka njoftuar bojkotimin e procesit, ndërsa të pranishëm pritet të jenë 8 deputetë rebelë që mbështetën paktin për emrin me

Greqinë, më 19 tetor. Pas miratimit të amendamenteve, parlamenti i Maqedonisë pritet të votojë marrëveshjen më 15 Janar.

Londër, deputetët votojnë në 15 janar për Brexit

Në 29 mars pritet largimi nga BE, "Brexiters" komprometojnë marrëveshjen për miratim

Më 15 janar deputetët britanikë do të votojnë për marrëveshjen e Brexit të negociuar midis Londrës dhe Bashkimit Europian, deklaroi ditën e djeshme një zëdhënës i Downing Street, ndërsa ekzekutivi pësoi disfatën e parë në parlament. Deputetët do të japin verdiktin e tyre duke nisur nga ora 19:00 (ora lokale dhe GMT) pas disa ditë debatesh që do të rinisin të mërkurën në Dhomën e Komuneve. Por tashmë miratimi i tekstit duket i



Kryeministria britanike, Theresa May

kompromentuar pasi është kritikuar si nga "Brexiters" edhe nga eurofilët si një kërcënim për një largim brutal nga BE-ja më 29 mars. Shenjë e një konteksti

armiqësor, deputetët e vunë në vështirësi qeverinë të martën duke votuar një amendament për projektligjin e financave, i depozituar nga opozita laburiste, i cili kaloi me 303 vota pro kundrejt 296 kundra në sajë të mbështetjes së konservatorëve të shumicës. Teksti redukton kompetencat fiskale të qeverisë në kuadër të një Brexit pa marrëveshje, nëse nuk arrihet dakordësia e parlamentit. Ndërkaq, vetëm tri ditë më parë, kryeministria britanike tha se Britania e Madhe

rrezikon të futet në "rrugë të panjohura" nëse ligjvënësit e saj nuk votojnë marrëveshjen e propozuar për daljen e vendit nga Bashkimi Europian. Ky ishte paralajmërimi që Theresa May u drejttoi kundërshtarëve të saj politikë të dielën, pak ditë përpara mbledhjes së parlamentit për të diskutuar marrëveshjen e Brexit. Në një intervistë për rrjetin publik anglez të lajmeve BBC, kryetarja e qeverisë premtoi një sërë masash që do të bindin më skeptikët të votojnë pro marrëveshjes rreth javës së dytë të janarit.

Policia australiane raporton: Ngjarja po hetohet, s'ka të lënduar

Pako të dyshimta në 13 konsullata në Australi, nisin evakuimet

Alarmuan ambasadat, zarfet përmbanin material asbesti

Që prej ditës së djeshme shërbimet e emergjencës në Australi po u përgjigjen raporteve për pako të dyshimta në disa ambasada dhe konsullata në Melburn dhe Canberra. Pavarësisht se autoritetet ende nuk kanë zbuluar objektivat specifike, Shtetet e Bashkuara dhe zyrat diplomatike britanike janë midis një liste të misioneve diplomatike në Melburn që janë evakuuar pasi u shfaqën njoftimet për paketën e dyshimtë. Zyrat e zviceranë, gjermanë, koreanë, grekë, italianë, indianë, pakistanezë dhe egjiptianë u njoftuan, gjithashtu. Shërbimet e emergjencës, janë duke hetuar aktualisht incidentin. "Nine News Australia" tha në një raport të fundit se të paktën 13 konsullata morën pako të dyshimta, të cilat mund të kenë përmbajtur të materialit të "asbestos". Paket, të cilat nuk duken të rrezikshme, u analizuan nga shërbimet emergjente, tha policia. Disa përfaqësues të ambasadeve janë evakuuar. Konsullata britanike në Melburn ishte një nga të parët që mori pakon. Konsullata e Shteteve të Bashkuara në Melburn gjithashtu mori një pako "të dyshimtë". "Vic Emergency", agjencia përgjegjëse për emergjencat dhe duke u referuar qeverisë së shtetit të Victoria, kryeqyteti Melbourne, raportoi disa produkte të dyshimta të zbuluara në qytet, pranë ambasadeve dhe konsullatave diplomatike të Span-



Policia australiane duke marrë pakot e dyshimta

BASHKËSHORTI I KONSULLES ZVICERANË

"Ne e vendosëm zarfin menjëherë në një qese dhe i njoftuam shërbimet emergjente për ta marrë atë", ka thënë bashkëshorti i konsules Manuela Erb, shkruan "BBC".

jës, Japonisë, Egjiptit, Indisë dhe Pakistanit. Thuhet se në disa prej pakove ka pasur materiale të forta dhe çimento, ndërsa në mbështjellësin e tyre shkurruhet se përmbajnë asbest. Nuk ka pasur raportime për persona të lënduar. "Pakot janë duke u hetuar nga shërbimet emergjente,

ndërsa rrethanat e këtyre incidenteve janë duke u zbuluar", ka deklaruar Policia Federale e Australisë. Punëtorët e ekipeve të emergjencës janë parë duke i larguar disa pako të mëdha, në të cilat shkruhet "Rrezik - Azbest". Incidentin e ka konfirmuar edhe një zyrtar i Komision-

it të Lartë Britanik, i cili ka thënë se konsullata britanike në Melbourne ka qenë cak i këtyre incidenteve, por se i tërë stafi ndodhet në hapësirë të sigurt. Një zarf i vogël me asbest i është dërguar edhe konsullatës zviceranë në Melbourne. "Ne e vendosëm zarfin menjëherë në një qese dhe i njoftuam shërbimet emergjente për ta marrë atë", ka thënë bashkëshorti i konsules Manuela Erb, shkruan "BBC". Ndërkaq, para dy ditësh ambasada e SHBA-së në Athinë është sulmuar në 03:30 të mëngjesit nga pjesëtarë të grupimit

POLICIA AUSTRALIANE

"Pakot janë duke u hetuar nga shërbimet emergjente, ndërsa rrethanat e këtyre incidenteve janë duke u zbuluar", ka deklaruar Policia Federale e Australisë.

anarkist "Rouvikonas". Mediat greke raportojnë se drejt saj disa persona të këtij grupimi kanë hedhur nga motorët e tyre shishe e tullumace të mbushura me bojë të kuqe. Policia ka ndaluar për këtë sulm vandal tetë persona të këtij grupi anarkist, që e ka marrë vet përgjegjësinë e sulmit përmes një postimi në internet. Anarkistët kanë shpjeguar se sulmi ka ardhur si një reagim ndaj politikës së SHBA-së në Siri, si dhe ndaj marrëveshjes së Greqisë me Maqedoninë për të ndryshuar emrin e kësaj të fundit në këmbim të anëtarësimit në NATO. "Rouvikonas" ka kryer sulme të ngjashme edhe në të kaluarën kundër ambasadeve, organizatave shtetërore greke dhe zyrave të partive politike.

SHKURT

Acari në Europë, humbin jetën 19 persona

Ftohti siberian vijon të lshkaktojë viktimat në Europë. Aktualisht bilanci është të paktën 19 të vdekur nga ngricat dhe stuhitë e dëborës. Frika më e madhe e autoriteteve është për të moshuarit. Një burrë 72-vjeçar në Greqi ndërroi jetë si pasojë e të ftohtit ekstrem dhe pamundësisë së ndihmës së shpejtë. Një tjetër person u gjet i ngrirë brenda parkingut të tij në qytetin e Sllatinës në Rumani, ku temperatura arriti në -24 gradë Celcius. Shumica e personave të pajetë janë gjetur në resortet e skive. Të njëjtin fat mund të kishin edhe disa skiatorë në Alpet franceze, të cilët u shpëtuan nga aftësitë e jashtëzakonshme të pilotit të helikopterit. Në Austri dëbora më shumë se 2 metra e lartë ka mbuluar makinat. Drejtuesit e mjeteve e kanë të pamundur të lëvizin pa zinxhirë. Stuhitë e dëborës kanë paralizuar edhe disa rajone jugore në Gjermani, ku autoritetet kanë shpallur gjendjen e jashtëzakonshme.

Ish-ministri izraelit:

Kam spiunuar për Iranin

Ish-ministri izraelit Gonen Segev do të burgoset për 11 vite pasi ka pranuar që ka spiunuar për Iranin, thotë Ministria e Drejtësisë e Izraelit. Segev ka shërbyer si ministër i Energjisë së Izraelit në vitet '90. Dyskohet se ai ishte rekrutuar nga Irani kur punonte si mjek në Nigeri. Ai u akuzua se kishte nxjerrë informacione të hollësishme rreth zyrtarëve izraelitë dhe vendeve të sigurisë së veçantë. Gonen Segev u arrestua në muajin Maj në Guinenë Ekuatoriale dhe u ekstradua në Izrael. 63-vjeçari do të dënohet zyrtarisht në secancën dëgjimore më 11 shkurt. Shërbimi i Brendshëm i Sigurisë së Izraelit tha se në vitin 2012, Segev kishte kontaktuar me zyrtarët e ambasadës iraniane në Nigeri dhe kishte vizituar dy herë Iranin. Atij i ishte dhënë një sistem i klasifikuar i komunikimit për të dërguar mesazhe të koduara për sektorin energjetik, informacione për vendet e sigurisë në Izrael dhe për zyrtarët të institucioneve politike dhe të sigurisë. Nga autoritetet iraniane nuk është bërë asnjë koment.

Opinion i Ditës

A ka faj interneti për ringjalljen e autoritarizmit?

Nga Juan Ortíz Freuler*

Gjatë viteve të fundit, ndikimi potencialisht i dëmshëm i internetit dhe sidomos i mediave sociale mbi demokracinë ka dominuar gjithnjë e më shumë lajmet. Një 'e-mail' i rrjedhur nga kompania "Facebook" kohët e fundit, që zbuloi se punonjësit i lejonin kompanitë partnere të mbledhin të dhënat e përdoruesve për një tarifë të caktuar janë më të fundit në një linjë të gjatë skandalesh përreth platformave të mediave sociale. "Facebook" është akuzuar gjithashtu së bashku me "Twitter" për nxitjen e përhapjes së informacionit të rremë. Në tetor, gazeta braziliane "Folha", dëshmoi se si kandidatura e Xhair Bolsonaro përfitoi nga një fushatë e koordinuar e dezinformimit, e realizuar përmes "Whatsapp", që është në pronësi të "Facebook". Dhe ka shqetësime në rritje se kjo taktikë mund të përdoret për të deformuar zgjedhjet parlamentare në Indi në prillin e vitit që vjen. Duke pasur parasysh këto zbulime alarmante, është e lehtë të mos lihen mënjënjë mënyrat përmes të cilave vetë interneti luan një rol në forcimin e demokracisë. Kjo i lejon qytetarët të mobilizohen në shtete autoritare, po aq sa edhe në demokraci të qëndrueshme. Duke e zhdukur hapësirën fizike dhe duke u dhënë akses shumë njerëzve në komunikimin global, ai është veçanërisht i efektshëm në lejimin e grupeve që të ndajnë historitë e tyre, të eksplorojnë identitetet e tyre dhe të zbulojnë të vërteta të pakëndshme rreth dinamikës së pushtetit.

Përmes rrjetit, grupet e pafavorizuara kanë qenë në gjendje të tejkalojnë filtrin e medias, që e paraqitin gjendjen e tyre si një koleksion rastesh të izoluar dhe që zbulonin natyrën sistematike të diskriminimit me të cilin përballeshin. Kuptohet, ekziston një mospajtim i konsiderueshëm në lidhje me balancën neto, gjershinë dhe proceset themelore, që ushqejnë ndikimin e internetit në shoqëri. Por, unë kam identifikuar 3 grupe konkurrese: "negacionistët", "narrativistët" dhe "arkitekturalistët". Negacionistët (mohuesit), e mohojnë që interneti është përgjegjës për problemet që shohim sot në botë. Ata besojnë se interne-

ti është po aq neutral sa edhe një pasqyrë. Dhe nëse njerëzit nuk e pëlqejnë atë që po prodhon interneti, duhet të hedhin më mirë sytë te pabarazia e madhe, që është e përhapur në shoqëritë e tyre. Ata thonë se në një botë në rrjet, ku njerëzit mund të koordinohen lehtësisht, toleranca ndaj padrejtësisë është më e vogël dhe shoqëritë tona të drejta nuk janë më të qëndrueshme. Ashtu si shtypi që mendohet se ka ndikuar në rënien e feudalizmit, edhe autostrada e sotme e informacionit thjesht po bën më të dukshme padrejtësitë. Interneti i lejon njerëzit të bëhen bashkë dhe të luftojnë padrejtësitë. Shkurtime, mesazhi i tyre është që ne duhet të rregullojmë padrejtësinë, jo internetin. Ky kamp, përfshin shumë analistë të medias që mbuluan Pranverën Arabe. Ndërkohë narrativistët pohojnë se bashkëpunimi social kërkon një narrativë të përbashkët dhe se interneti - ku mijëra zëra janë të kundërt në një mënyrë kaotike - e minon këtë synim. Ata theksojnë se mikro-tarqetimi i reklamave politike u mundëson kandidatëve politikë të përhapin mesazhe të ndryshme dhe shpesh kontradiktore, tek njerëz të ndryshëm. Narrativistët gjithashtu theksojnë se koordinimi i madh i mundësuar nga interneti i ka dëmtuar agjentët tradicionalë të pushtetit, si partitë politike e sindikatat dhe ka ushqyer mijëra grupe interesash të ngushta. Dikur argumentojnë ata - agjentët tradicionalë të pushtetit do të punonin për krijimin e një platforme që mund të organizonte vazhdimisht një mori idesh dhe kërkesash. Sot interneti po nxit një sistem kaotik të çështjeve politike, ku udhëheqësit mund të premtojnë të kujdesen për një gamë të gjerë grupesh interesi, pa shpjeguar se si secili premtim përshatet brenda një kuadri më të gjerë të mendimit. Ky kamp përfshin shumë nga mediat tradicionale, të cilat mbështeten në argumentet e paraqitura nga ekspertët nga universitetet kryesore në Britani dhe SHBA. Ndërkohë arkitekturalistët pohojnë se interneti nuk është një strukturë fikse dhe se ajo që po shkakton ankthet e sotme, mund të gjurmohet në zhvillime relativisht të fun-



dit në arkitekturën e internetit. Ata argumentojnë se dizajni origjinal i internetit krijoi stimuj që njerëzit t'i kushtojnë vëmendje cilësive së përbashkët që krijojnë dhe ndajnë. Në fillimet e tij, interneti nuk kishte rojtare dhe një treg të hapur idesh, të cilat në mënyrë organike të tentonin të promovonin të mirën mbi përmbajtjen e

keqe. Përkundrazi, modeli i të ardhurave të bazuara tek reklamat, i ndjekur nga shumë gjigantë modernë të teknologjisë, nxit angazhimin ndaj përmbajtjeve që janë sensacionale, por jo domosdoshmërisht të një cilësie të mirë.

Kush ka të drejtë? Secili prej tri kampeve ka të drejtë në një pikë. Një pjesë e vogël


e kompanive private kontrollojnë informacionin që nevojitet, për të kuptuar se si funksionon ekosistemi 'online'. Ata menaxhojnë infrastrukturën kryesore dhe shumica e ekspertëve në këtë fushë po e drejtojnë këtë infrastrukturë, pasi kanë nënshkruar një marrëveshje për mos-zbulim. Kështu, alegoria e Plato-

ni me Shpellën mund të jetë një metaforë më e përshatshme. Kontrolli mbi të dhënat kryesore i lejon këto kompani të luajnë rolin e padronit-hije. Ata kanë shansin të zbulojnë vetëm pjesët e realitetit, që ata gjejnë se janë të përshatshme, duke përcaktuar se si publiku i gjerë e percepton hapësirën në internet.

Reduktimi i informacionit nuk është pra vetëm pasojë e natyrshme e novacionit të internetit. Ai është krijuar artificialisht dhe për qëllime strategjike: Të formësojë opinionin publik. A duhet t'i disiplinohet këto kompani të mëdha? Apo të mos bëjmë asgjë? Çfarëdo që bëjmë, duhet të jetë rezultat i një debati të fuqishëm publik. Një debat që të bazohet në provat më të mira në dispozicion, lidhur me efektet që interneti ka në marrëdhëniet e pushtetit. Në këtë pikë, ne kemi nevojë për informacione kyçe që duhen zbuluar dhe që të jenë në dispozicion për shqyrtim publik. Por informacioni është pushtet - dhe nuk ka gjasë të zbulohet vullnetarisht. Kjo mund të kërkojë një rregullim ligjor. Ajo që kemi është një hendek në rritje mes vendit ku shtrihet pushteti dhe atij ku veprojnë institucionet që kërkojnë ta mbajnë përgjegjësinë ndaj njerëzve. Institucione të tilla nuk janë në gjendje të sigurojnë që udhëheqësit e zgjedhur në mënyrë demokratike të mund të përmbushin premtimet e tyre për fushatë.

Kjo është ajo tek e fundit që shkakton tensione shoqërore dhe minon besimin në demokracinë tona. Ne kemi nevojë që institucionet tona, t'i interpretojnë këto tensione si "flamuj të kuq" dhe si një thirrje për nevojën e një kontratë të re shoqërore. Dhe ne kemi nevojë për institucione që të reagojnë tani. Kjo situatë shkon shumë larg debatit rreth digitalizimit. Megjithatë, hapësira në internet është e ardhmja jonë, ndaj ky boshllëk është më i dukshëm dhe urgjent. Nëse institucionet tona aktuale të qeverisë nuk arrijnë të sigurojnë që revolucioni i vazhdueshëm teknologjik t'i vendosë njerëzit të parët, këto institucione herët a vonë do të bëhen të parëndësishme.

* Marrë me shkurtime nga OpenDemocracy.net/Bota.al


 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
NJOFTIM PËR EKSPERTË DHE SPECIALISTË TË PAVARUR

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe Vendimit të KPP-së nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", KPP shpall konkurrimin për plotësimin e listës vjetore të Ekspertëve dhe Specialistëve të Pavarur në fushat: *Ekspert vlerësimi i pasurive të paluajtshme; ekspert kontabël i regjistruar; inxhinier elektronik/informatik; inxhinier mekanik; inxhinier hidrologjik; inxhinier elektrik; inxhinier gjeologji-minierash; inxhinier mjedisi; inxhinier ndërtimi; inxhinier tekstilë; kimist; specialist në farmaceutikë.*

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë në fushën ku ai do të konkurrojë.
2. Të ketë licensë në fushat ku ligji parashikon pajisjen me të.

Pagesa dhe shpenzimet e ekspertëve apo specialistëve të pavarur do të bëhet me parapajtim nga pala ankimese.

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 08 Shkurt 2019 në selinë e Komisionit të Prokurimit Publik këto dokumenta: kërkesën për aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, fotokopje të licensës si ekspert, të librezës së punës, vërtetimitin e gjendjes gjyqësore, fotokopje të kartës së identitetit, numër kontakti, si dhe adresën e plotë të vendbanimit

FOTOGRAFI

Fatmira Nikolli

NIKOLIN PICI

Burri me aparat që fiksoi portretet e pilotëve e kapitenëve

Imazhet që shihen i ngajjnë sekuenca të filmave ameri-kanë në Vietnam. Gjendja që përcjellin, çasti i ndalur në kohë, tensioni dhe emocioni veçse të grishin për të parë më shumë se ç'ndodh përtej letrës bardhezi. Janë imazhe nga stërvitjet e strukturave të ndryshme të forcave ushtarake shqiptare, portrete pilotësh, tankistësh, artiljerësh a xhenierësh. Autori i këtyre fotove, u nda nga jeta dhe u përcoll për në banesën e fundit krejt në heshtje.

Është Ylli Drishti që përmes një e-maili njofton se mjeshtri i fotografisë Nikolin Pici, u shua dhe iku.

Emri i tij kërkon vëmendje edhe pse vinte nga Dinastia e Fotografëve Shkodranë "PICI". Si i tillë, ai ishte rritur në "Odën e territ", prej ku dilnin në dritë imazhet e fiksuara të personazheve e njerëzve të thjeshtë. Nëse fëmijët e tjerë luanin në atë moshë, Nikolini merrte leksionet e para të fotografisë bardh e zi pranë të atit.

Në ditët e para të një moti pa të, Ylli Drishti na kujton se Nikolin Pici ishte pjesë e grupit të fotografëve të Laboratorit Fotografik Qendror të Ushtrisë Shqiptare ku bën pjesë Petrit Ristani, Agron Kruti, Kosta Bej, Bujar dhe Alma Duka të drejtuar fillimisht nga nxënësi i Gegë Marubit të madh - Rrok Berisha. Detyra e tyre ishte dokumentimi i veprimtarisë (stërvitjeve dhe jetës) së repartëve të Ushtrisë Shqiptare të të gjitha llojeve të armëve. "Në një farë mënyre prej këtij stafi fotografësh dhe laborantësh si pjesë e atij që emërtohej Laboratori Qendror Fotografik i Ushtrisë në ato vite, kemi të plotë "DITARIN FOTOGRAFIK" të ushtrisë shqiptare pas luftës së dytë botërore duke përfshirë edhe Paradat Ushtarake të kohës", thotë Drishti. Kujton se Nikolini u bë pjesë e këtij stafi në moshën 18 vjeçare dhe pas 11 vjetësh (1959-1970) ai do të kalonte si fotograf i revistës së ilustruar ushtarake "10 Korriku" (1970 - 1990). Gjatë viteve 1983-1990, Nikolini ishte koleg në të njëjtin laborator fotografik (në Ministrinë e Mbrojtjes) me mjeshtër tjetër të fotografisë Alqi Gollosi, që mbulonte shërbimin fotografik për gazetën "Luftëtari". Nikolin Pici i shërbeu për 31 vjet Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Ministrisë e Mbrojtjes duhet të jetë krenar me emrin e tij dhe brezave të fotografëve që i shërbyen asaj. Me respekt duhet të kujtohet emri i tij edhe nga Ministria e Kulturës dhe Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë ku Nikolini punoi gjatë viteve 1990-2000. "Emrin e tij e mbajmë tashmë shumë botime të rëndësishme të ushtrisë shqiptare dhe të historisë së arteve pamore në Shqipëri", thotë Drishti.

Mjeshtri i Fotografisë Nikolin Pici lindi në Shkodër më 24 tetor 1940. Ai përkëtohej të fotografëve shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit XX, me traditë familjare. Nikolini ishte djali i fotografit të njohur shkodran Shan Pici dhe artin e fotografisë e mësoi nga i ati që në moshën 14 vjeç. "Oda e territ" si quhej në dialektin shkodran, dhoma e errët e laboratorit



Nikolin Pici



do të bënte pjesë në programin didtor të Nikolin Pici, krahas lojërave të moshës. Ishin këto leksionet e para të fotografisë bardh e zi, që krahas kontakteve të përditshme me punën e të atit për të fotografuar qytetarët në studio apo dhe gjatë realizimit të peizazheve në natyrë, krijuan pasionin për fotografinë; pasion që Nikolini e ruajti gjithë jetën brenda kohës së tij si artist. Gjatë viteve 1959 - 1962, Pici ushtar - fotograf do të realizonte fotografitë e para dokumentare në Laboratorin Qendror Fotografik të Ministrisë së Mbrojtjes, ku dhe pas ushtrisë viteve 1962-1970) do të bëhej pjesë e stafit profesionist të këtij laboratorit të rëndësishëm. Në arkivin gjigand të laboratorit emri i Nikolin Pici zë vend të rëndësishëm. Aty janë me mijëra fotot (negativa e diapozitiva) që kanë dokumentuar (nën syrin e një profesionisti dhe fotograf serioz), imazhe nga stërvitjet e strukturave të ndryshme të forcave ushtarake shqiptare, veprimtaritë kulturore - artistike dhe jeta ushtarake. Brenda kuadrantit të një dokumentimi dhe orientimeve të sakta ushtarake, artisti Pici ka gjetur gjithmonë hapë-

Ylli Drishti: Lamtumirë mjeshtri i fotografisë, realizoi mijëra imazhe të ushtarakëve



Nikolin Pici

sira të këndvështrimeve emocionale e realiste. Në mijëra e mijëra fotografi të këtyre viteve do mund të gjenden portrete pilotësh të sarsitës nga mijëra metra lartësi, tankistë, artiljerë, xhenierë, vullnetarë ushtarakë, paradat ushtarake të ushtrisë shqiptare, të cilët pasqyrojnë një mjet bukur në imazhet e tyre energjinë, burërinë dhe bukurinë njerëzore.

Në vitet 1970 - 1990 Nikolin Pici ishte fotograf i botimeve të Ministrisë së Mbrojtjes Shqiptare (revis-

Mbrojtjes, ka realizuar dhe vepra të tjera fotografike në gjininë e peizazhit dhe portretit. Tradita familjare e lëvrimin të fotografisë bardh e zi nga i ati, ka lënë gjurmë dhe tek Nikolin Pici, i cili me mjaft kujdes kërkonte dhe gjente bukurinë e "lojës" së dritë - hijes në natyrë. Peizazhi në fotot e Nikolin Picit ka brenda tij magjinë e "gjetjes" fotografike, të bukurisë dhe delikatesës së imazhit të paraqitur. Duke ruajtur me mjaft kujdes "sharmin" e një fotografi klasik, ai kërkoi dhe solli me objektivin e tij edhe bukurinë e detajit, duke i dhënë fotografisë përsosmëri emocionale.

Gjatë udhëtimeve të shpeshta dhe në vendet nga më të bukurat e më të largëta (atje ku ishin vendosur njësitë ushtarake shqiptare), Pici ka fiksuar përvëç imazheve të ushtarakëve që ishin të veçanta e me gjetje kompozicionale nga më të interesantet edhe magjinë e bukurisë së natyrës shqiptare. Në përgjithësi veprat fotografike të Nikolin Picit kanë brenda tyre qetësi dhe një dritë delikate që evidenton bukurimazhin e fiksuar.

Mjeshtri Nikolin Pici bën pjesë në grupin e fotografit klasik shqiptar i viteve 1960 - 1990. Ai u formua në studion e të atit dhe ruajti traditën e mjeshtërtëve të fotografisë shqiptare si: Marubi, Radovani, Ristani, Jakova, Nënshati, Gollosi, Kallfa, Veseli. Ai ishte mik dhe koleg me Alqi Gollosin, Petrit Kumin, Refik Veselin, Petrit Kumin, Besim Fushën dhe Leon Çikën. Ylli Drishti, studjues e kurator arti thotë se Nikolin Pici ka qenë prezent me fotografitë e tij në albumet e botuara nga Ministria e Mbrojtjes deri në vitet 1990 dhe më tej në botime të tjera të veçanta për artin ikonografik. Ndër këto botime mund të kujtojmë: Albumet "25 vjet Ushtri Popullore", "Marshon Shqipëria Socialiste", "Ushtria Popullore në artet figurative", "Ikona Shqiptare" (2001, Autor Y.Drishti, Botim i Galerisë Kombëtare të Arteve, Tiranë) dhe "Ikona bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri" (2007, Autor Y.Drishti). "Artistët e fotografisë shqiptare, kolegët dhe familja do ta kujtojmë me respekt figurën e Nikolin Picit, Pasi vepra e tij që na la trashëgimia është shumë planëshe. Fotografia shqiptare humbi një nga mjeshtër të saj; familja burrin e urtë, babain e dashur dhe fjalëmbël, fotografin e pasionuar dhe qytetarin korrekt Nikolin Pici. Nikolin Pici, tashmë është pjesë e historisë së plejadës së mjeshtërtëve të fotografisë shqiptare të shekullit XX. Mirënjohje të thellë për mjeshtër Nikolin Pici - respekt për krijimtarinë e tij dhe figurën shembullore të njeriut të kompletuar", shpreh Drishti.

ta "10 Korriku") por ai botonte edhe në gazetën "Luftëtari". Fotografitë e tij, gjithashtu, do të ishin pjesë dhe e mediave të tjera të kohës (revista "Ylli", "Shqiptarja e re", "Shqipëria sot" etj.). Në vitin 1982, Pici çel dhe ekspozitën e tij vetjake me 130 vepra fotografike me temë nga ushtria shqiptare. Gjatë viteve 1990 - 2000, Pici ishte fotografi i Galerisë Kombëtare të Arteve, Tiranë, ku ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në dokumentimin e veprimtarive artistike të saj si dhe në botimet që Galeria ka realizuar (katalogët me titull: "Ikona Shqiptare" (2001), "Monografi", "Thoma Thoma", (1997), revista "Pamorart" etj.).

Pici krahas një krijimtarie të fotografisë dokumentare të jash-tëzakonshme për mbi 30 vjet që realizoi gjatë punës në sektorin e botimeve të Ministrisë së

Opinion i Ditës

Kandidaturë e spikatur për kreun e KiE-së

Nga Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)


... i Këshillit të Evropës (KiE). Natyrisht që ai ka marrë para-praktisht viston e shumicës së vendeve anëtare. Zgjedhja e tij në këtë post të lartë që është vetëm formalitet do të bëhet nga Asambleja Parlamentare e KiE dhe pritet të fillojë detyrën më 1 tetor.

Kësisoj, Belgjika do të drejtojë për herë të parë organizatën më të madhe panevropiane të themeluar 70 vjet më parë në Londër dhe me seli në Strasburg, pika historike e ballafaqimit, pajtimit dhe miqësisë franko-gjermane dhe evropiane. KiE është prej shtatë dekadash në pararojë dhe kampion i mbrojtjes/zhvillimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut; të mishëruara në Konventën e famshme me 200 protokolle dhe anekse të tjera ligjore dhe të garantuar ligjërisht nëpërmjet Gjykatës së saj autoritare të të Drejtave të Njeriut, ku dhe Shqipëria ka prej vitesh gjykatësinë saj.

Siç dihet, Këshilli i Evropës dhe sekretarja e tij e Përgjithshme Katherine Lalumiere u bënë dritë shprese për vendin tonë në agimin e demokracisë. Shqipëria aderoi në KiE në vitin 1995, kur opozita e atëhershme socialiste kreu një akt politik, qytetar dhe emancipues për atë periudhë; pranoi këtë anëtarësim edhe pse lideri i saj Fatos Nano ishte praktikisht i burgosur politik, me shpresë se gjërat do të shkonin më mirë.

Sikurse pohojnë shumë politologë dhe analistë, Didier Reynders e meriton të jetë në krye të Këshillit të Evropës për shumë arsye; në radhë të parë si drejtues i lartë politik dhe shtetëror me përvojë 35 vjeçare i një vendi si Belgjika, bashkëthemelues i KiE-së, NATO-s dhe BE-së, mbrojtës dhe model i respektimit të të drejtave të njeriut, bujar në pritjen dhe integrimin e shtetasve nga 180 kombësi të ndryshme, i multikulturalizmit, ndihmës dhe mbështetës i forcave dhe proceseve demokratike dhe denonues i atyre despotike. Belgjika ka qenë dhe mbetet në frontin e parë të betejës kundër terrorizmit, diskriminimit, ndërmjetësues e krizave në Lindjen e Mesme, Ballkan dhe gjetkë. Ajo renditet e gjashta në Evropë për shumën e ndihmave për vendet në zhvillim me 0,64 nga 0,70 për qind të GDP-së si objektivi i OKB-së; krahas kontributit politik, njerëzor dhe ushtarak në vatrën më të nxehta përfshi Kosovën, Belgjika ka kontribuar me mbi 300 milionë euro me ndihma humanitare për Sirinë, Irakun, Afganistanin, Palestinën, etj.

Tipar dallues i këtij shteti federal dhe me shumë vlera në ditët e



© Belgium Foreign Affairs, Foreign trade and Development

sotme është toleranca, mirëkuptimi, konsensusi mbipartiaq me gjithë luftën e ashpër politike, bashkëjetesa ndërmjet popullsisë, komuniteteve fetare, gjinore, gjuhësore, etj. Vend i rrallë ku kryeqyteti i tij kozmopolit euro-atlantik ndodhet mes veriut me përbërje

dhe gjuhë flamande, protestant dhe industrial, ku qeveris tradiconalisht e djathta dhe jugut valon frëngjishtfolës, katolik, bujqësor dhe ku qeveris historikisht qendra e majtë. Pa harruar dhe komunitetin gjerman në lindje të vendit; të gjithë me qeverinë dhe Parlamen-

tin e tyre, veç nivelit federal.

Qysh nga viti 1985, e sidomos në dy dekadat e fundit, në të gjitha këto dhe të tjera fusha ka dhënë ndihmesën e vet të spikatur e të vlerësuar ndërkombëtarisht Didier Reynders, zv kryeministër dhe ministër Federal i Financave deri në vitin 2011 dhe nga ky vit e në vazhdim ministër i Jashtëm. Edhe si lider i partisë në pushtet "Lëvizja Reformatore" (MR) gjatë periudhës 2004 - 2011 dhe në vazhdim si një ndër drejtuesit e saj kryesorë dhe deputet në shumë legjislatura.

Gjatë shtatë viteve në krye të diplomacisë belge, Reynders e ka shfaqur dhe me shumë formatin dhe personalitetin e gjerë shumë-planësh, duke fituar admirimin e kolegeve të shumtë.

Në vitin 2014 - 2015 ai drejtoi me shumë vlerësime Presidencën e Këshillit të Evropës mes krizave të shumta, sidomos aneksimin e

Ukrainës nga Rusia, terrorizmi, azili, etj. Gjatë asaj periudhe ai u shqua për prononcime dhe qëndrime të qarta si përfaqësues i KiE-së dhe BE-së kudo që shkoi; një mjeshtër i vërtetë i kombinimit të real politikës me diplomacinë etike, d.m.th. mbrojtjen e parimeve dhe idealeve të demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Dy vitet e fundit Reynders drejtoi fushatën e suksesshme lobuese belge, duke u zgjedhur për vitin 2019 - 2020 anëtare jo e përhershme e KS të OKB-së. Por për këtë jo vetëm u paraqitën platforma bindëse, por vetë Reynders ndërmori disa nisima, duke thirrur në Bruksel konferenca ndërkombëtare të nivelit të lartë mbi gjenocidin, terrorizmin, azilin, dhunën ndaj gruas dhe fëmijëve, etj.

Ai ka qenë nismëtar dhe pjesëtar në të gjitha ekipet e kryediplomatëve evropianë me propozime për reformimin cilësor të BE-së, kundërshtar i vendosur i Brexitit, populizmit, ekstremizmit dhe "izmave" të tjerë, një evropianist i palëkundur.

Reynders njihet dhe si dashamirës dhe mik i vendit tonë dhe Kosovës, në kuptimin e vërtetë të fjalës. Belgjika dhe vetë Reynders kanë mbështetur qysh në fillim proceset demokratike në Ballkan dhe në Tiranë; ishte ndër të parat që i tha: "PO" anëtarësimi tonë në OSBE, KiE, NATO, statusit kandidat dhe çeljes së negociatave të anëtarësimit me BE-në.

Duke punuar si Këshilltar dhe Ministër Këshilltar në Ambasadën tonë në Bruksel nga viti 1997 - 2001 dhe 2011 - 2017 i kam parë dhe ndërjerë nga afër këto cilësi të Reynders në takime të ndryshme, bisedime qeveritare dhe raste të tjera. Dashamirësinë e tij ndaj vendit tonë e kemi parë të rrezatuar dhe të bashkëpunëtorët e tij më të afërt të cilët i mbajnë përherë hapur dyert për ne, pa protokoll.

Më 15 Shkurt, Reynders shkoi për vizitë zyrtare në Tiranë duke shpëruar dhe ndihma humanitare për familjet e përmbytura në Shkodër. Fill pas asaj vizite, me nismën e tij u ftuan në Bruksel për një javë 10 diplomatë dhe punonjës të administratës sonë publike për një trajnim në kuadrin e BE-së.

Reynders ishte ndër të parët Ministrat të Jashtëm të BE-së që shkoi në Beograd e në Prishtinë në vitin 2013 dhe 2014 për të nxitur dhe inkurajuar dialogun e Brukselit. Belgjika dhe Reynders janë ndër të parët që njohën pavarësinë e Kosovës dhe kanë mbështetur përherë anëtarësimin e në organizata ndërkombëtare.

Ndaj, zgjedhja e pritsme e Didier Reynders në krye të KiE-së është arritje e re cilësore e politikës/diplomacisë belge dhe ngjarje e mirëpritur kudo dhe në Shqipëri.

Opinion *i* Ditës

Problemet në çift çojnë deri në vrasjen e gruas

Nga Anxhela Peza

(vijon nga faqja 1)

... Një burrë nga Ballshi vrau gruan dhe kumatën, një shqiptar tjetër në Selanik vrau të bijën dhe e varrosi në oborrin e shtëpisë së tij. Një tjetër burrë qëllon me thikë gruan e tij, e cila gjendet aktualisht në koma. A thua se çdo shqiptari i lind e drejta të vrasë gruan e tij.

Përse çiftet agravojnë deri në marrjen e jetës

Shumica e martesave kryesisht në vendet rurale në vendin tonë ende realizohen me mblesëri. Me miratimin e prindërve. Emigrantët shqiptarë kthehen nga vendet fqinje dhe europiane për t'u martuar me një grua shqiptare, siç e kërkon zakoni i vendit që i përkasin. Pra, sado ato jetojnë në një vend të huaj ku të drejtat e gruas dhe trajtimi i femrës është primar, në boshtin e tyre të formimit të personalitetit të tyre mbetet psiko-edukimi kulturor dhe modeli prindëror familjar me të cilët janë rritur. Kemi një paralelizëm, burri është shtylla e shtëpisë dhe pushteti i tij përmban dhunën psikologjike dhe fizike gjithashtu. Nga ana tjetër, kemi gruan, e cila duhet të durojë më çdo kusht martesën e shkatërruar dhe të mos pranojë asnjëherë të ketë divorc apo ndarje. Shumë çifte shqiptare janë të "martuar" me dasmën tradicionale dhe jo të celebruar. Duket sikur përgjithësisht më e madhe bie mbi gruan sa është e zonja ajo të durojë.

Për dhunën nuk flitet. Të flasësh për dhunën është diçka ende e rrezikshme për jetën e vetë gruas. Ajo nuk e denoncon dhunën pasi është e ndjeshme duke menduar se po denoncon babain e fëmijës. Apo nuk mund të ketë një martesë tjetër për shkak të paragjykimëve. Në herët e para që mund të jetë ankuar nuk është përkrahur nga familjarët e saj duke i thënë se duhet të jesh e zonja ta bësh burrin për vete që të mos dhunojë, tradhtojë, keqtrajtojë. Problemi shikohet se vjen nga ajo



vetë. Ndarja në çift konsiderohet ende "një turp" për shumicën e zonave rurale në vendin tonë. Kërkesat më të mëdha për divorc janë vetëm në Tiranë. Në vitet e tjera kemi plot raste të regjistruara të vrasjes së gruas edhe pse të ndara nga burri, ai e quan përsëri veten burri i saj. Siç mbahet mend nga të gjithë rasti i gjyqtarës Firdes. Ndërsa shumë gra të tjera të popullatës sonë kanë marrë emër për mënyrën e tmerrshme e humbjes së jetës së tyre. Duket patur çifte të tilla, rriten fëmijë të tillë. Cikllit përsëritet burra të dhunshëm dhe gra të nënshtruara.

Pse nuk denoncohet dhuna ligjërisht. Ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis denoncimit dhe varësise psikologjike. Shumë femra të dhunuara në mënyrë sistematike kanë qenë preh e depresionit dhe episodeve të tjera të trishtimit. Pamundësia ekonomike, pasi shumë prej grave janë shtëpiake dhe nuk kanë pavarësi. Një tjetër faktor janë mirë strukturimi i politikave sociale. Duke filluar që nga qendrat e mirëfillta të rehabilitimit për gruan vetë dhe fëmijët. Mbështetja ekonomike për ato gra të divorcuara dhe kërkojnë një

asistencë sociale e cila të jetë e mjaftueshme për të jetuar. Të jeni të sigurtë se çdo grua, e cila dhunohet fizikisht kërcënohet në mënyrë të vazhdueshme se po u largua do të vritet, ose do i merret apo vritet fëmija. Frika është e tmerrshme të kërcënohesh për gjënë më të shtrenjtë. Sugjeroj që legjislacioni i vendin tonë të ndryshojë në strategjinë mbi këtë fenomen të tmerrshëm ndaj gruas. Nuk mund të jenë kaq shumë të guximshëm burrat kur përballesh me një ligj të hekur.

*** Psikologe Klinike dhe Këshillimi**

HOROSKOPI

DASHI

Një zë i pjekur dhe praktik brenda kokës vazhdon t'ju thotë se ajo që njerëzit e tjerë mendojnë për ju nuk duhet të ketë rëndësi. Gjithashtu, për momentin, mund të keni nevojë të merrni një rol të pakëndshëm në mënyrë që të arrini atje ku ju keni nevojë.

DEMI

Sot do të ishte më mirë të qëndroni në shtëpi sesa të dilni. Përkujdesja për punët e vogla do të jetë shumë më qetësuese për ju sesa perspektiva e një projekti të madh që mund të ndryshojë komunitetin.

BINJAKET

Gabimet e kaluara ose hapat e gabuar janë si uji nën urë, nuk mund të qëndroni mbi to kur mendoni se çfarë duhet të bëni më pas. Kur të angazhoheni në një projekt të ri, romancë apo punë, duhet të keni një mendje të hapur dhe një qëndrim të fortë se çdo gjë është e mundur.

GAFORJA

Dikush pranë jush po kalon disa ndryshime të mëdha humor, prandaj keni kujdes se një humor i lehtë mund të kthehet në lot me pak provokim. Ka shumë gjëra për të cilat nuk mund të jeni të vetëdijshëm, dhe këto ndryshime ekstreme në sjellje janë fillimi i një trendi të ri.

LUANI

Kushtojni më shumë vëmendje të dëgjuarit! Merrni kohë shtesë për të dëgjuar informacione të rëndësishme apo edhe komplemente! Njerëzit rreth jush po flasin dhe kjo është një kohë e mrekulueshme për të fituar njohuri shtesë.

VIRGJERESHA

Nëse gjërat nuk kanë marrë rrugën e seriozitetit me një person tjetër, sot është dita për t'i shtyrë gjërat në një fushë shumë më romantike. Nëse doni që gjërat të rriten, ju do të duhet t'i edukoni. Rrethojë veten me qirin, muzikë të qetësuese.

PESHORJA

Dikush që zakonisht është një burim i diellit të ndrihtëm në jetën tuaj po ndihet paksa në depresion tani. Sot ju do të mbani çelësin për ta ngritur shpirtërisht atë. Sigurohuni që linjat e komunikimit të jenë të hapura. Përpjekjet tuaja do të vlerësohen shumë.

AKREPI

Nëse ndaloni për një moment dhe mendoni, do të kuptoni se betejat më të mëdha të jetës suaj kanë qenë pak më shumë se betejat e vullmetit. Pra, nëse hasni konflikte sot, mbani këmbë në mendje. Nëse mund të përdorohesh në armë të një qëllimi sot, asgjë dhe askush nuk mund t'ju ndalojë.

SHIGJETARI

Vendosni një prioritet për shpenzimet tuaja sot. A po i çoni të gjitha burimet tuaja në vendin e duhur? Ju nuk duhet të shkurtoni të gjitha shpenzimet tuaja - shpenzimi i parave nuk është diçka e gabuar, por ju duhet të siguroheni që po hapni portofolin tuaj në kohën e duhur dhe për arsytet e duhura.

BRICJAPI

E vërteta e ftohtë, e vështirë është mjaft e thjeshtë. Nuk mund të kesh një rezultat pozitiv nëse rrethohesh vetëm me energji negative. Pra, sot, sigurohuni që gjithçka që bëni është e përcenduar rreth gjërave të mira që po përpigoni të arrini - dhe jo gjërat e këqija që po përpigoni t'i shmangni.

UJORI

A jeni duke ngelur në klasë sa i përket departamentit të disiplinës? Një makinë ose dhomë gjumi e çregullt nuk është fundi i botës, por kur numri i enëve në lavamanin tuaj është më i gjatë se ju, atëherë mund të ketë një problem.

PESHQIT

A mund të konsideroheni një lider apo udhëheqës kur askush nuk ju ndjek? Kjo është një pyetje për të cilën duhet të mendoni sot. Merrni më shumë nga roli i udhëheqës dhe u jepni njëzëre diçka për të besuar. E dhe vetëbesimi do të ishte një fillim i mirë në këtë aspekt.

MIQËSORET E DJESHME

Partizani ka barazuar me rezultatin 1-1 në miqësoren e zhvilluar në Antalia ndaj turqve të Sivasporit. Një paraqitje dinjitoze për skuadrën e Skënder Gegës, që kaloi e para në avantazh me anë të Asanit në minutën e 47-të. Sivaspori arriti të barazonte shifrat në minutën e 67-të me anë të Torje, i cili u tregua i saktë nga pika e bardhë e penaltisë. Në pjesën e parë, Gega i besoi formacionit titullar

që kishte përdorur më së shumti në kampionat, teksa nuk munguan zëvendësimet e shumta në pjesën e dytë, ku spikat aktivizimi i Hyseni, që iu bashkua së fundmi Partizanit, pas aventurës pozitive me Flamurtarin. Kukësi ka luajtur ndeshjen e parë të fazës përgatitore në Antalia të Turqisë, ku është vënë përballë kryesuesve të kampionatit turk, Istanbul Bashak-shehir. Skuadra e drejtuar nga Armando Cungu nuk ka zhgënjyer në këtë test, edhe

Partizani e Kukësi bëjnë mirë në Turqi, Skënderbeu humb Bregun

pse është mundur me rezultatin 2-1 nga ekipi vendës. Bashakshehir ka qenë dominues në këtë ndeshje, me Kukësin që ka menduar më shumë të mbrohet përballë lojtarëve turq. E megjithatë, këta të fundit kanë gjetur dy herë rrjetën me anë të Bajić në pjesën e parë dhe Epureanu në të dytën. Gjithsesi, për të bërë

ndeshjen më të bukur, ka menduar zëvendësuesi Çyrbja, i cili ka shënuar golin e 2-1 në minutën e 71 të takimit. Skënderbeu mposhti me rezultatin 2-1 Tiranën në miqësoren e zhvilluar në Durrës, në kuadër të përgatitjeve për gjysmën e dytë të Kategorisë Superiore. Pjesa e parë u mbyll me fitoren 1-0 të bard-

hebluve, ndërkohë në të dytën korçarët arritën të përmbysin gjithçka falë golave të Ardit Hoxhaj dhe Oto Xhon. Vlen për t'u theksuar goli i futbollistit vlonjat, që shënoi nga goditja e dënimit. Momente paniku për korçarët në sfidën e djeshme, teksa mesfushori Dejvi Bregu është larguar nga fusha në përfundimin e pjesës së parë pas një dëmtimi serioz në shpatull, ndërsa mësohet se ylli i Skënderbeut do të qëndrojë 3 muaj larg fushave të blerta.

URIBE E PËSON KEQ



Ish-portieri i Meksikës dënohet me 75 vjet burg

Omar Ortiz Uribe ish te një ndër lojtarët më të mirë që Kombëtarja e Meksikës ka pasur në gjirin e saj. I njohur si "El Gato", ish-portieri ka përfunduar në burg, me një dënim prej 75 vitesh. Gjykata e drejtësisë në Meksikë ka vendosur që pas 7 vitesh të kaluara nga Omar në burg, më në fund të jepet gjykim për 42-vjeçarin. Ai do të jetë i burgosur në shtetin e Nuevo Leon, në burgun e ferrit, "Cereso Cadereyta". Pas një dënimi të marrë në vitin 2010-të për skualifikim, pasi kishte përdorur doping, në 2012-tën ai përfundonte skualifikimin dhe ishte gati që të futej në botën e futbollit përsëri. Por, policia e ka vënë në pranga për pjesëmarrjen e tij në një bandë grabitësishe dhe rrëmbyesish. Drejtësia meksikane ka provuar pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në të paktën 3 rrëmbime nga Ortiz, duke përfshirë edhe atë të një vajze të mitur. Gjatë procesit të gjatë hetimor u zbulua se Ortiz ishte në borxh ndaj kartelit kriminal "Gulf", për shkak të përdorimit të bollshëm të kokainës. Tashmë në moshën 42-vjeçare, duket se ai do ta kalojë pjesën tjetër të jetës në burgun e ferrit.



Jeton Selimi

33-vjeçari kërkon të shmangë befasishtë në fund të sezonit, kur lufta për mbijetesë ashpërohet

Plaku: Përvoja na ndihmon, e pamë vjet se çfarë ndodhi

Kapiteni i Kamzës shpreson në mbërritjen e përforcimeve

Vit i ri, energji të reja për Kamzën. 2018-a u mbyll me një fitore mjaft të rëndësishme kundër Skënderbeut, por në tërësi, pjesa e parë e sezonit ishte zhgënjyese për skuadrën nga rrethinat e kryeqytetit. Tashmë po ndërtohen bazat, me qëllim që ekipi të qëndrojë në Superiore. Kapiteni Sebino Plaku beson se situata do të ndryshojë për mirë, pavarësisht se ka disa rezervat për mënyrën e organizimit. "Kemi vuajtur pak në pjesën e organizimit, sepse ende nuk është vendosur se çfarë do të bëhet me fazën përgatitore. Po vuajmë pak edhe temperaturat e ftohta, pjesa tjetër është normale. E kemi nisur vitin me energji të reja", tha Plaku për "Supersport"

33-vjeçari zbulon një objekt të ri në merkaton e Kamzës, prioritet sipas tij nuk është ardhja e përforcimeve, por ruajtja e grupit aktual dhe evitimi i "hemorragjisë", teksa komenton edhe largimin e Erlis Frashërit. "Largimi i Frashërit ka qenë i detyrues, por presidenti është munduar që ta ruajë pjesën tjetër të grupit. Ka pasur kërkesa edhe për lojtarë të



tjerë, por nuk po largohen. Shpresoj që ta çojmë deri në fund këtë punë që kemi nisur. Dihet që në janar është e vështirë të gjej lojtarë

cilësorë. Gjithsesi, nuk përjashtohen surpriza të bukura, sikurse ishte për Teutën marrja e Frashërit". **Cila është arma kryesore**

e Kamzës në luftën për mbijetesë? Sipas kapitenit, "diferencën në raste të tilla e bën gjithnjë përvoja në situata të vështira, kjo


NENSHKRIMI
Kamza ka zyrtarizuar ditën e djeshme 27-vjeçarin David Izazola. Ky i fundit do të jetë një përforcim në sulm për Gjokën. Meksikani është prezantuar në ambientet e klubit. Izazola ka një CV të pasur dhe ka qenë pjesë e shumë klubeve. Sulmuesi ka nënshkruar për 1 vit e gjysmë me kamzalinjtë.

skuadër e disponon eksperiencën e duhur për t'a mbyllur pa lot këtë edicion të Superiores. Synimi ynë është të qëndrojmë në Superiore, pastaj mënyra sesi rrjedh kampionati... E pamë edhe vjet sesi shkuan ngjarjet, përvoja na bën edhe më të fortë".

"BOMBA" NGA ARGJENTINA

Vanda Nara refuzon rinovimin e Icardit me Interin

Zhvillime tek Interi sa i takon rinovimit të kapitenit Mauro Icardi. Deri tani ishin vetëm zëra, por "ESPN" dhe "TyC Sports" shkruajnë se Uanda Nara i ka komunikuar klubit zikaltër se Icardi nuk dëshiron ta rinovojë kontratën. Masimiliano Alegri, trajneri i Juventusit, e kërkon në skuadër, por klauzola e kapitenit të Interit nuk është e vlefshme për në Itali, kështu që kandi-



dat i fortë për sulmuesin argjentinas është Çelsi i Sarrit. Por edhe Reali i Madridit vazhdon të qëndrojë në gjurmët e tij ende. Nga sa kuptohet, telenovela e rinovimit të Icardit me Interin ka mbërritur në kapitullin e fundit. Sulmuesi del kështu automatikisht në merkato dhe mbetet për t'u parë kush do ta paguajë klauzolën e tij prej 110 milionë eurosh, Reali apo Çelsi.

Kërkohet zëvendësuesi i Rabio


PSG interesohet për Raxha Naingolan

Klubi i PSG-së, pas largimit të Adrien Rabio, do të ketë një grup të madhe në mesfushë dhe i duhet patjetër të marrë një futbollist për këtë repart. Trajneri Thomas Tuchel ka kërkuar nga presidenti Naser Al-Khelaifi dhe drejtori sportiv Antero Henrique, që pavarësisht vështirësive për të gjetur lojtarë të lirë me kualitet në këtë periudhë, të mos sjellin në ekip lojtarë poshtë shifrës së 30 milionë eurove. Sipas "Foot01.com", drej-



tuesit e klubit kampion në Francë po ndjekin Karlos Soler të Valencias, por edhe Raxha Naingolan të Interit. Madje, për këtë të fundit mësohet se ka pasur edhe një takim. E vështirë që bisedimet të mbyllën pozitivisht, por PSG-ja do ta provojë. Interi duket se ka rastin të shpëtojë nga mesfushori belg, i cili është bërë problem kohët e fundit me sjelljen e tij jashtë fushës së blertë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Niven që që aktor.
5. Little..., kryeqyteti i Arkansas.
7. Janë tek në lakër.
10. Nuk ka akoma një bebe.
11. Kufizojnë katete.
12. Penn aktor.
13. Hector që shkroi Pa familje.
15. Thahen me bonifikime.
18. Mbyllin takimin.
19. Ndërmarrje Industriale Mat.
21. Mbyllën me epilog.
23. Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
25. Ishin sandalet e lëkurëkuqve.
27. Njëllor për latinët.
30. Eshhtë vend si Katar.
31. Pupi regjisor.
32. Janë strehat e çobanëve.
33. Eshhtë centrali si Chernobyl.
35. Fillojnë një argument.
36. Të parat në stadium.

37. Mund të sjellin shi.
38. Kështu fillon Odisea.
39. Një mund të jetë emërore.
42. Thirrje edhe kështu Persefoni.
44. Ai dhe ajo.
45. E ka lënë atë që s'ka fuqi
48. Para es Salaam.
49. Ylli i Londrës.
50. Eshhtë syzë... në komo.

VERTIKALI

1. Hyskja aktor.
2. Kush e thotë lutet.
3. Një tis mjegulle.
4. Maiden që këndojnë.
5. Gjysmë rekord.
6. Antonio skulptor i famshëm.
7. David regjisor.
8. Janë brinjë në skuadër.
9. Ruan në kufij.
12. Mban mikrofonin.
14. Janë edhe ato të fytyrës.
16. Quheshin edhe Eumenide.
17. Demek pa kufij.
20. Mund të jetë atomike.
22. Qyteti i përjetshëm.
24. Kitara e Ravi Shankar.
25. Janë katrore në sipërfaqe.
26. Një fjalë si gjoja.
28. Pak daktilografi
29. Eshhtë si divan.
31. Një pjesë e amerikanëve.
32. Bernhardt që që aktore.
34. Eshhtë infeksion në veshë.
38. Një mund të jetë unik
40. Gjysma e sasisë.
41. Pak marramendëse.
43. Eshhtë dhomë.
45. Fillojnë takimin.
46. Në fund majtas.
47. Të fundit në manastir.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. E bardhë ajo Moby Dick.
5. Fillojnë amplifikimin.
7. Eshhtë vit që parashikohet.
10. Mbyllin pamjen.
11. U printe jeniçerëve.
13. Thurman aktore.
14. Një reaksion në provëz.
16. Një sport me brez të zi.
19. Në fund të fundit.
20. Janë në gjyq.
23. I është hequr të dënuarit.
24. Eshhtë shahu i fundit
25. Janë fletë trëndafil.
27. Kufizojnë një metër.
28. Tregojnë pallate në miniaturë.
29. Një fjalë pa shkak.
30. Janë përllogaritje.
32. Mbyllin një dritare.
33. Të parat në muzg.
34. Me të nxjerrin një letër.

VERTIKALI


35. Janë me ngjyra të tilla si tunxhi.
37. Toromani balerinë.
39. Iniciallet e Reimann regjisor.
40. Fillojnë politikën.
42. Një piktor si Antonio Ligabue.
44. Difong në dietë.
46. Një lind në kokë.
48. Kush ka... do të pijë.
49. Punojnë në galeri.
52. Fillojnë titrat.
53. Mund të jetë ekspres.
54. Mund të skadojë.
7. Nuk i bihet me kokë.
8. Sharif aktor.
9. Janë organet e taksave.
12. Me Haensel në përrallat e vëllezërve Grimm.
15. Vihen për të mbyllur.
17. Janë vegla.
18. Eshhtë medalja e të parit.
21. I dhimsset frikacakut.
22. Mund të jetë mbi xhiro.
26. Eshhtë llahatar.
28. Janë inate të akumuluar.
30. Eshhtë vëlla i gruas.
31. Një tip për të këcyer.
33. Edoard piktor.
36. Lumë në Francë.
38. Janë djemtë e... nënës.
41. Lindi Akilin.
43. Kodi i celularit.
45. Mbledh basket separatistë
47. Një është edhe Egjieu.
49. Fillojnë një metodë.
50. Dy anët e një neni.
51. Fillojnë ofensivën.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

S E V E N U P S T E F F I
 A M I N K A P I T A L I
 R I T E T R E L A M
 A L E T F I L O K T E T I
 H E P R O T O K O L L A R E K
 K A T A M I K A Z E K
 I R C O L I N R O M Y
 T E M A E I B O R I S
 A N I T A A M I L A N O
 R A N V I T M J E R A N
 E T I L E N F R A T I

FJALËKRYQI (1)

B A O B A B P E D A N A T
 R P E R I P A T E T I K E
 A P E L R I V I B N A R
 V E L P T R A M I D A M
 A R K O L O R I T T L E
 P R O T A G O N I S T E T
 K A N T A T A T K A T E T
 A R I E L T A K U R T
 S A L A T I K U R T S
 P A E S I P I R A T T I
 I R M I B A N O R E T
 K R A T E R E T G J I R I

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

2			7 8		3	
						8
5	9			1	4	
4 5		3 6				1
6		7		2		
	1 2					
	2					5
			1 8			7
		7 5				6

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	4	7	3	6	9	8	5	1
8	3	5	7	1	2	4	6	9
1	6	9	4	8	5	7	2	3
3	7	6	8	4	1	5	9	2
4	2	8	9	5	6	1	3	7
9	5	1	2	7	3	6	8	4
5	1	3	6	2	4	9	7	8
6	8	2	1	9	7	3	4	5
7	9	4	5	3	8	2	1	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Banker: Ai që ju jep ombrellën e tij kur koha është me diell, dhe ua merr atë mbra, kur fillon të bjerë shi.

- Lufta nuk është të vdesësh ti për atdheun tënd, por ai idioti tjetër të vdesi për atdheun e tij.

- Në thelb, kam nevojë vetëm një gotë pije për të dehur. Problemi është se unë nuk e mbaj mend, nëse kjo është e trembëdhjeta apo e katërmëdhjeta.

- Kush tha se është herët për të pirë? Tashmë është nesër në Europë dhe dje në Kinë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T	A	Z	O	V	E	T	N	A	B	A		
D	I	A	B	E	T	I	D	E	T	I	Z	A	G	A	R	R	A	M	B	A	S	
R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T	I	C	K	A	L	I	N	I	O	B	I	
F	E	N	I	M	O	R	E	T	R	I	L	C	A	S	U	S	B	E	L	L	I	
F	E	K	O	N	O	M	I	A	D	T	E	N	T	A	T	I	V	A	T	V		
R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E	M	A	R	T	I	N	A	E	N	K	E	
A	N	T	E	N	A	A	T	A	A	B	E	T	E	S	E	N	R	O	M	A	N	
N	A	N	T	E	S	T	L	A	R	A	T	I	M	E	T	I	P	I	A	F	E	
K	N	E	I	I	L	I	R	E	T	A	M	O	R	F	R	A	T	A	R			
I	B	A	N	A	K	A	E	T	L	O	N	Z	E	T	A	F	A	Z	A			
B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D	E	R	I	C	C	E	V	O	N	E		
E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I	T	E	A	M	A	L	B	A	N	E	T	

Thënie të mençura

- Kam filluar dietë. Ndalova dhe pijen, dhe në dy javë kam humbur 14 ditë.
- Asnjëherë mos e shtyj për nesër atë që ju mund të bëni pasnesër.
- Bota filloi pa njeriun dhe do të përfundojë pa atë.
- Unë e dua njerëzimin. Njerëzit nuk mund të duroj.
- Dikur kam qenë i pavendosur. Tani nuk jam i sigurtë.
- Shëmtia është superndaj bukurisë, sepse ajo zgjat më shumë.

